BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE

The Banker
Bank of the Year 2020
KOSOVO



Raporti Vjetor 2020

01
Rreth BKT-së

02
Misioni, Vizioni dhe
Vlerat Themelore

03
BKT Kosova,
të Arriturat

04
Përgjegjësia Sociale
e Korporatës

05
Çmimi nga
The Banker

06
Kryetari i Holdingut,
Kryesuesi i Bordit dhe
Kryeshefi Ekzekutiv

07
Bordi i Drejtorëve

08
Menaxhmenti i Lartë

09
Grupi i Bankingut
Individual

10
Covid 19 - Ndikimi
në BKT

11
Grupi i Bankingut të
Korporatave
dhe Bizneseve

12
Grupi i Thesarit,
Institucioneve Financiare
dhe Bankingut Privat


13
Grupi i Menaxhimit të Kredive
dhe Çështjeve Ligjore


14
Grupi i Menaxhimit
të Riskut

15
Burimet Njerëzore
dhe Trajnimet

16
Të Dhënat e
Audituara Financiare







Histori e madhe që formëson të ardhmen

Rrënjët e Bankës Kombëtare Tregtare janë themeluar më 29 nëntor 1925 me krijimin e degës së parë në ndërtesën historike në Durrës që përfaqëson institucionin më të vjetër financiar në Shqipëri.

BKT, me emrin që e mban sot, u themelua në janar 1993 nga ndërmarrja e përbashkët e Bankës Tregtare Shqiptare me Bankën Kombëtare të Shqipërisë. BKT u regjistrua si aksionar në vitin 1997 dhe sot është banka më e madhe dhe më e vjetër në Shqipëri. BKT përfundoi procesin e saj të privatizimit në vitin 2000 dhe më 30 qershor 2009 Çalık Holding u bë aksionari i vetëm i BKT-së.

Duke pasur një strukturë të konsoliduar të kapitalit dhe me përparësi të shumta dhe dinamike konkurruese, BKT filloi një fazë të re të rritjes dhe suksesit të qëndrueshëm. Duke qenë banka më e vjetër dhe ofruesi i parë i shërbimeve financiare në vend, BKT ka përvojë të rrënjosur thellë, njohuri të detajuara lokale, një kulturë të fortë korporate dhe një qasje më inovative për ta përkrahur vizionin e saj.

BKT, hapi degën e saj të parë në Kosovë, përkatësisht, në nëntor 2007, disa muaj përpara shpalljes së Pavarësisë së Kosovës (17 shkurt 2008).

BKT solli përvojën dhe trashëgiminë e saj të gjatë, në këtë vend të porsalindur. Që nga ai moment, BKT dhe Kosova vazhduan të rriten së bashku dhe ta ndihmojnë njëra-tjetrën të përparojnë. Me përkushtim maksimal, duke filluar me personel prej 11 personash, Banka Kombëtare Tregtare zgjeroi rrjetin e saj në 16 qytete të Kosovës duke u pozicionuar më pranë klientëve me 26 degë dhe agjenci dhe në të njëjtën kohë duke rritur numrin e të punësuarve në 389.

Më 30 prill 2018 Banka Kombëtare Tregtare Dega në Kosovë, ndryshoi statusin e saj nga degë e një banke të huaj në një në një bankë subjekt të varur? Tani, ajo është bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, me ndryshimin e statusit, banka ndryshoi emrin e saj nga Banka Kombëtare Tregtare Dega në Kosovë në Banka Kombëtare Tregtare Sh. A. Kosovë.

BKT Kosova është vlerësuar me çmimin prestigjioz Banka e Vitit 2020 për Kosovën nga The Banker, e cila është revistë financiare që publikohet nga The Financial Times.

Duke shënuar rritjen më të lartë gjatë tri viteve të fundit në Kosovë dhe duke marrë parasysh rritjen dhe zhvillimin e fortë, cilësor dhe premtues gjatë vitit 2020, suksesi i BKT Kosova u njoh ndërkombëtarisht. BKT Kosova operon me një përqendrim të fortë në bankingun ndërkombëtar dhe partneritetet globale, si dhe në përmirësimin e shërbimit të saj ndaj klientëve me qëllim që të sigurojë qasje në shërbime bankare për të gjitha kategoritë e klientëve: Individët, korporatat, NVM-të dhe mikro-ndërmarrjet. BKT Kosova është një nga bankat me rritjen më të shpejtë në tregun e Kosovës dhe ka ritmin më të shpejtë dhe më inovativ të digjitalizimit në industrinë bankare të vendit.





Misioni

Të kontribuojmë në rritjen e standardeve të jetesës duke përdorur talentet dhe energjinë tonë për të zhvilluar zgjidhje që u shtojnë vlerë jetëve të njerëzve, duke u ofruar njerëzve qetësi, komoditetet dhe mundësi në sektorin bankar.

Vizioni

Të rritemi dhe të bëhemi bankë udhëheqëse në Kosovë duke shtuar vlerë për çdo jetë që prekim në secilën prej fushave tona të veprimit, me ekipe të besueshme dhe të fuqizuara nga shpirti ynë inovativ dhe ndërmarrës.

Vlerat Themelore dhe Parimet e Punës


Njerëzit tanë udhëhiqen nga vlerat themelore dhe parimet kryesore të punës si më poshtë:


Vlerat Themelore:

- *Drejtësia*
- *Të punojmë me zemër*
- *Reputacioni*
- *Orientim njerëzor*
- *Inovacioni*
- *Shkathtësia*
- *Qëndrueshmëria*
- *Integriteti*
- *Besueshmëria*
- *Transparenca*

Parimet e Punës:

- *Puna ekipore*
- *Llogaridhënia*
- *Komunikimi i hapur*
- *Cilësia*
- *Efikasiteti*
- *Fokusi tek klienti*





1925
Dega e Parë

Dega e parë hapet
në Durrës

1926
Degë të reja

Hapen degët e
Shkodrës dhe Vlorës

1993
Themelimi i BKT-së

BKT themelohet pas bashkimit
të BTSH dhe BKSH

1997
Shoqëri aksionare

BKT shndërrohet në
Shoqëri Aksionare

2000
Privatizimi

BKT përfundon procesin
e privatizimit

2007
BKT Kosova


BKT themelohet në Kosovë
si Degë e BKT Shqipëri

2009
Çalik

Çalik blen 100%
të aksioneve

2018
BKT Kosova

BKT Dega Kosovë
shndërrohet në Bankë



Dega e parë e Bankës Kombëtare Tregtare u themelua në Durrës më datë 29 nëntor 1925, në godinën historike ku sot ndodhet Dega e BKT në Durrës. Godina në të cilën ndodhet kjo degë e BKT-së përfaqëson aktualisht institucionin financiar shqiptar më të vjetër në vend. Më 1 nëntor 1926 dhe 15 nëntor 1926 u hapën respektivisht degët e Shkodrës dhe të Vlorës.

Banka Kombëtare Tregtare me emërtimin që ka sot u themelua në janar 1993, nga bashkimi i Bankës Tregtare Shqiptare (BTSH) dhe Bankës Kombëtare të Shqipërisë (BKSH). Ndërkohë sot BKT është banka më e madhe e dhe më e vjetër tregtare në Shqipëri. Aktivet dhe pasivet nga aktivitetet e këtyre subjekteve iu transferuan llogarive të BKT-së që prej formimit të saj.

Banka Kombëtare Tregtare u krijua si Shoqëri Aksionere në korrik 1997 me një kapital prej 2.7 miliardë Lekësh.

BKT-ja përfundoi procesin e privatizimit në vitin 2000. Parlamenti shqiptar aprovoi me 6 korrik 2000 kontratën e shitjes ndërmjet Ministrisë së Financave nga njëra anë dhe Konsorciumit të Investitorëve Ndërkombëtare (60% e aksioneve), Korporata Ndërkombëtare Financiare (20%) dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (20%) nga ana tjetër. Kalimi i pronësisë u bë efektiv me 17 Tetor 2000. Aksionerët e rinj derdhën 10 milionë dollarë, duke rezultuar në një kapitalizim të fuqishëm të bankës. Nën drejtimin e aksionerëve të rinj dhe menaxhimit të ri, të përbërë thuajse terësisht nga një staf i huaj me eksperiencë të gjerë ndërkombëtare, BKT-ja ndërmori transformime rrënjësore në 2001, për ndërtimin e infrastrukturës dhe ristrukturimin e çdo aspekti operacional të bankës duke filluar që nga personeli, procedurat e deri tek infrastruktura e teknologjisë së informacionit dhe shndërrimin e burimeve të veta njerëzore në një skuadër të re e dinamike profesionistësh të angazhuar për të arritur nivele përsosmërie. Viti 2006 filloi me një faqe të re për BKT. Me të marrë aprovimin nga Banka e Shqipërisë dhe vendimin e posaçëm gjyqësor, me 9 Qershor 2006 u miratua transferimi i aksioneve që konsistonte në kalimin e 60% + 2 të aksioneve të BKT në favor të Çalik-Seker Konsorsiyum Yatirim A.S.

Pas vendosjes për zgjerim edhe ne Kosovë, numri i degëve ne Kosovë arrin në 27, duke e bërë BKT-në bankën shqiptare më të madhe në rajon.

Më 30 Qershor 2009, Çalik Financial Services blen pjesën e aksioneve të Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim duke u bërë në këtë mënyrë aksionerja e vetme e BKT me 100% të aksioneve.

Gjatë viteve 2006 – 2011 BKT, me performancën e arritur merr një seri vlerësimesh kombëtare dhe ndërkombëtare, ndër të cilat disa herë rresht si “Banka më e mirë e vitit” në Shqipëri, Banka më e mirë, ndër bankat e nivelit të mesëm, në Europën Juglindore” duke kulmuar me vlerësimin si “Banka më e mirë e vitit në Europën Juglindore në vitin 2009”. Njëkohësisht për dy vite rresht, BKT vlerësohet me notën AAA (Alb) nga instituti prestigjioz JCR- ER. Në të njëjtën kohë Banka e Shqipërisë për të tretën herë dhe për të pestin vit rradhazi vlerëson BKT me notën 1- Strong sipas Sistemit të Vlerësimit Bankar CAMELS duke konstatuar në këtë mënyrë rritjen akoma më të madhe të besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së BKT në sistemin bankar shqiptar. Njëkohësisht revista prestigjioze e sektorit bankar The Banker, pjesë e Financial Times, vlerëson 2 vite rresht (2010 dhe 2011) BKT-në si bankën e vitit në Shqipëri.

Prej 2011, BKT vazhdoi të rrisë pjesën e saj të tregut në çdo segment të shërbimeve bankare duke u bërë kështu dhe banka më e madhe në vend përveçse më e vjetra. EMEA Finance dhe Euromoney e vlerësuan BKT si Banka më e mirë në Shqipëri për vitin 2012, ndërsa JCR-ER e vlerësoi me notën AA(Alb) për Qeverisjen e Korporatave. Viti 2013 ishte viti më i suksesshëm për BKT pasi ajo mundi të fitojë të tre çmimet më prestigjoze të sektorit bankar duke u shpallur Banka më e mirë në Shqipëri nga EMEA Finance, Euromoney dhe The Banker, ndërsa Drejtori i Përgjithshem i BKT fitoi çmimin “CEO i Vitit në Europë” nga EMEA Finance. Sukses ky që u përsërit në vitin 2014 duke fituar përsëri jo vetëm tre çmimet e mëdha por edhe çmimin për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës nga EMEA Finance dhe notën AAA(Alb) për Qeverisjen e Korporatave nga JCR. Viti 2015 është viti i 90 i veprimtarisë financiare të BKT.

Më datën 30 Prill, 2018, Banka Kombëtare Tregtare Dega në Kosovë ndryshon statusin e saj nga Degë e Bankës së huaj në Bankë Shoqëri Aksionare. Me ndryshimin e statusit Banka ka ndryshuar edhe emrin nga Banka Kombëtare Tregtare Dega në Kosovë në Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.





Ne fokusohemi në ndërtimin e një bote më të mirë

Banka Kombëtare Tregtare Sh.A është e angazhuar në shumë projekte që lidhen me mjedisin, komunitetin dhe përgjegjësinë sociale, në mënyrë që të japë kontribut në shoqëri, si dhe të krijojë vlerë për vendin duke ofruar produkte dhe shërbime cilësore dhe duke krijuar mundësi për punësim.

Përshkrimi i konceptit të përgjegjësisë sociale të BKT-së bazohet në parimin "Kontribuoni për shoqërinë". Nga kjo pikëpamje, BKT e përkrah drejtpërdrejt ose tërthorazi mjedisin, artet e ndryshme, aktivitetet sportive dhe arsimore.

Instrumentet më të rëndësishme të përgjegjësisë sociale të BKT-së janë sponsorizimet dhe aktivitetet e ndryshme të bamirësisë që i pasqyrojnë vlerat e institucionit ndaj shoqërisë dhe punonjësve.

Për nder të Ditës së Dhurimit të Gjakut, më 14 qershor 2020, BKT Kosova në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, vijoi dhurimin e gjakut, që tashmë është traditë disa vjeçare e bankës.

BKT vazhdon të jetë përkrahëse e veprimeve që në qendër kanë individin dhe mbështetjen e tij në komunitet. Niveli i lartë i pjesëmarrjes së punonjësve të bankës në aktivitetin e dhurimit të gjakut dhe vullneti i tyre për të kontribuar në shëndetin e të tjerëve vërteton vazhdimisht se përqendrimi ynë duhet të jetë krijimi i ndikimit pozitiv në shoqëri.

“Gjaku yt shpëton jetë” është pjesë e programit të bankës për përgjegjësi sociale, i bazuar në parimin “Kontribuo për shoqërinë”, që i adresohet mbështetjes së Bankës Kombëtare Tregtare ndaj veprimtarive bamirëse.





Mbështetja dhe përkujdesja ndaj personave me nevoja të veçanta në Kosovë tashmë ka marrë kahun e dëshirueshëm, ndërsa ka shumë organizata të cilat ndihmojnë dhe përkujdesen për personat që kanë nevojë për një përkujdesje të veçantë. BKT Kosova ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shoqatën 'Autizmi' me seli në Prishtinë, për mbështetje financiare për trajtimin e fëmijëve me autizëm në periudhë 12 mujore.

Këtë mbështetje e ka mirëpritur edhe shoqata, 'Autizmi' e cila falënderon Bankën Kombëtare Tregtare për mbështetjen, ndërsa shpresojnë se shembullin e bankës BKT do ta marrin edhe të tjerët, njerëzit e vullnetit të mirë e kushdo tjetër për të mbështetur fëmijët me autizëm të cilët kanë nevojë të ndihen komod dhe pjesë e shoqërisë.

BKT Kosova gjithmonë e gatshme në përkrahje të tenisit në Kosovë. BKT ka qenë sponsori kryesor i turneut për femra të moshës së rritur "Ladies Open 2020", organizuar nga Federata e Tenisit e Kosovës. Turneu u mbajt në fushat e tenisit në periudhën 30 korrik deri më 02 gusht 2020.

BKT Kosova është e përkushtuar të kontribuojë në shoqëri, duke vepruar në mënyra të ndryshme, për të ndikuar pozitivisht në jetën e çdo qytetari.




Promovimi, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të personave me sindromën Down në Kosovë dhe familjarëve të tyre është misioni i Shoqatës Down Syndrome Kosova, e cila vazhdon të kërkojë mbështetje për shërbimet që ofrojnë, e së fundi kësaj thirrjeje i është përgjigjur me plot mirëkuptim BKT Kosova për t'u dalë në ndihmë në vazhdimin e ofrimit të shërbimeve terapeutike për fëmijë të diagnostikuar me sindromën Down.

Gjithashtu, BKT Kosova ka ndihmuar këtë shoqatë duke blerë produkte që fëmijët me Sindromë Down i përgatitën, në këtë mënyrë duke i dhënë mbështetje financiare Shoqatës "Down Syndrome Kosova".

Këtë mbështetje e ka mirëpritur edhe Shoqata 'Down Syndrome Kosova' e cila falënderon Bankën Kombëtare Tregtare për mbështetjen, ndërsa shpresojnë se shembullin e kësaj banke do ta marrin edhe të tjerët, qytetarët e vullnetit të mire, bizneset apo kushdo tjetër.



Dhurimi i 15 kompjuterëve për Shkollën Fillore dhe të Mesme të Ulët "Besim Nrecaj" është pranuar shumë pozitivisht nga kjo shkollë e cila ka pasur nevojë të madhe për një Kabinet Informatik kompjuterik ku nxënësit e kësaj shkolle do të jenë në hap me kohën e zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe do të lehtësojë punën metodike e didaktike të mësim-nxënies.







Çmimi nga The Banker

BKT Kosova është vlerësuar me çmimin prestigjioz Banka e Vitit 2020 për Kosovën nga The Banker, e cila është revistë financiare e publikuar nga The Financial Times.

Pasi ka shënuar ritmet më të larta të rritjes gjatë tri viteve të fundit radhazi në Kosovë, dhe duke marrë parasysh rritjen dhe zhvillimin e fortë, cilësor dhe premtues gjatë vitit 2020, suksesi i BKT Kosova u njoh ndërkombëtarisht. BKT Kosova operon me përqendrim të fuqishëm në bankingun ndërkombëtar dhe partneritetet globale, si dhe në përmirësimin e shërbimit të saj ndaj klientëve me qëllim që të sigurojë qasje në shërbime bankare për të gjithë dhe nga kudo, si për bizneset ashtu edhe për individët.

Duke komentuar për çmimin e pranuar, z. Suat Bakkal, Kryeshefi Ekzekutiv i BKT Kosova, thotë, “Suksesi ynë është i bazuar në aftësinë tonë për ta përkrahur ekonominë e Kosovës, si bankë universale, me një larmi të plotë të zgjidhjeve bankare të nivelit botëror, si për bizneset ashtu edhe për individët. BKT Kosova është një nga bankat me rritjen më të shpejtë në tregun e Kosovës dhe mban ritmin më të shpejtë dhe më inovativ të digjitalizimit në industrinë bankare të vendit ”.


Për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia, ngjarja e shpërndarjes së çmimeve nga The Banker, u zhvillua përmes një video konference të organizuar më 2 dhjetor 2020, ku Z. Bakkal mori pjesë dhe e pranoi çmimin për BKT Kosova. Ndërsa u shpall çmimi, Z. Bakkal vuri në dukje se, “BKT Kosova është e nderuar ta fitojë çmimin Banka e Vitit në Kosovë, në një vit të mbushur me sfida të sjella nga COVID-19. Çmimi në vetvete është dëshmi e punës së madhe të bërë nga kolegët e mi të të gjitha niveleve në organizatën tonë. Secili prej nesh ka qenë shumë i përqendruar në përkrahjen e strategjisë sonë të transformimit të bankës në një institucion të përqendruar te klientët, veçanërisht gjatë kohërave të vështira të sjella nga pandemia. Qëllimi ynë kryesor është të ofrojmë mundësi të shërbimeve bankare kudo, në çdo kohë dhe për të gjithë. Banka jonë do të vazhdojë të japë përfitime reale për klientët, kolegët dhe aksionarët tanë."

Rreth The Banker:

The Banker është burim i besuar i informacionit bankar që nga viti 1926. The Banker ka përvojë prej më shumë se 90 vitesh të mbulimit të shërbimeve bankare nga Rënia e Wall Street në vitin 1929 deri në krizën financiare të vitit 2008 me të njëjtin reputacion për saktësinë, autoritetin dhe integritetin. The Banker përpiqet të stimulojë dhe informojë, duke ofruar një vështrim të pashembullt me një gamë të gjerë të lajmeve, tipareve, analizave dhe intervistave dhe mbulimin e detajuar të të gjitha çështjeve kryesore me të cilat përballet sektori financiar.

Rreth BKT Kosova:

BKT Kosova operon në tregun e Kosovës që nga viti 2007. Deri në vitin 2018 banka operonte si degë e BKT Albania, ndërsa në prill 2018 banka ndryshoi statusin e saj nga Degë e Bankës së Jashtme në Bankë subjekt të varur dhe renditet si një nga bankat me rritjen më të shpejtë në industrinë bankare të Kosovës. BKT ka krijuar mundësi dhe zgjidhje të shumta bankare inovative dhe moderne, si dhe një larmi produktesh bankare konkurruese. BKT Kosova është e përkushtuar t’u shërbejë të gjitha kategorive të klientëve: Individët, korporatat, NVM-të dhe mikro-ndërmarrjet, ndërsa është e përqendruar fuqimisht në njohjen si partner bankar global. Për BKT-në rritje do të thotë të përjetosh ndryshime dhe t'u përshtatesh zhvillimeve të reja në çdo fushë, prandaj, banka vazhdimisht pranon zhvillimet më të fundit teknologjike në botën financiare duke investuar në trendet më të reja.





AHMET ÇALIK

Kryetar i Çalik Holding

E themeluar nga Ahmet Çalık në vitin 1981, Çalık Holding operon në disa sektorë: energji elektrike, ndërtimtari, prona të patundshme, tekstil, miniera, financa, në sektorin e telekomunikimeve dhe atë digjital. Me veprimtaritë e shpërndara në 28 vende që shtrihen në rajonin e Azisë Qendrore, Ballkanit, Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut (MENA).

Çalık Holding dallohet si lojtar i rëndësishëm në Turqi dhe madje në të gjithë botën me kompanitë e saj; në sektorin e energjisë me Çalık Enerji; në kërkimin e naftës me Çalık Petrol; në shpërndarjen e energjisë elektrike me YEDAŞ, YEPAŞ, KEDS në partneritet me Limak, ARAS EDAŞ dhe ARAS EPAŞ në partneritet me Kiler; në sektorin e ndërtimit me Gap İnşaat dhe Çalık Gayimenkul; në miniera me Lidya Madencilik dhe Polimetal Madencilik; në tekstil me Çalık Denim dhe Gap Pazarlama; në financa me Aktif Bank, BKT Albania (Banka Kombëtare Tregtare) dhe BKT Kosova (Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a); në telekomunikim me Albtelecom dhe në transformimin digjital me Çalık Dijital.

Gjatë gjithë veprimtarisë në të gjithë botën, Çalık Holding është e njohur për reputacionin e besueshëm, strukturën e fortë financiare dhe bashkëpunimin afatgjatë me kompani tjera ndërkombëtare. Ajo zhvillon modele inovative afariste dhe përparon në linjat e saj të biznesit me rritje të qëndrueshme. Çalık Holding, në përpjekje për të shtuar vlerë të përhershme në jetën e njerëzve kudo ku operon, përqendrohet në digjitalizimin e proceseve të saj afariste, shërbimeve dhe produkteve të zhvilluara me Industrinë 4.0, Shoqërinë 5.0 dhe qasjet e qëndrueshmërisë të cilat i ka përqafuar.





MEHMET USTA

Mesazhi i Kryesuesit

Mjediset sociale dhe ekonomike janë bërë gjithnjë e më sfiduese për shkak të efekteve të pa-precedent të pandemisë COVID-19. Efektet jo vetëm që po shkaktojnë rreziqe në sistemin shëndetësor dhe në ekonomi, por po e godasin edhe organizimin shoqëror dhe funksionimin e individëve. Rutina po ndryshon, po kështu edhe jeta, dhe industria bankare nuk bën përjashtim nga kjo.

Duke marrë parasysh rrethanat e dhëna, misioni i bankës mbetet në radhë të parë ofrimi i qetësisë për njerëzit, dhe ofrimi i komoditetit dhe mundësive në sektorin bankar. Bankingu duhet të jetë i lehtë dhe prandaj BKT Kosova qëndron sa më afër klientëve, duke e bërë shërbimin bankar të qasshëm dhe fleksibil në çdo kohë duke përdorur platforma online që e përbëjnë vlerën themelore të menaxhimit të marrëdhënieve me klientët, veçanërisht në kohëra si kjo.

Për ta ruajtur më tej këtë qëndrim, BKT Kosova ka përvetësuar përparësitë e saj konkurruese duke sjellë zgjidhjet më të fundit në treg, kryesisht të dedikuara për optimalizimin e shërbimeve që përdoren nga klientët dhe optimalizimin e proceseve të brendshme që ndihmojnë në kursimin e kostos dhe rritjen e numrit të klientëve për bankën.

Pavarësisht situatës së pandemisë, BKT Kosova ka arritur ta ruajë një nivel shumë të mirë likuiditeti, rritje të shëndetshme dhe kapital të fortë. BKT Kosova ka arritur ta ketë rritjen më të madhe të indikatorëve kryesorë në të gjithë sektorin në Kosovë. Viti 2020 ishte vit që ka karakterizuar suksesin e BKT Kosova, pra pas një kohe të gjatë që e ka ruajtur renditjen si e 5-ta sa i përket pjesës së tregut, BKT Kosova në vitin 2020 për herë të parë u rendit e 4-ta për nga madhësia e aseteve në treg, dhe i njëjti trend i rritjes së përshpejtuar dhe të shëndetshme është parashikuar dhe përkrahur nga Bordi i Drejtorëve.

Që banka të mund t'i përgjigjet tregut dhe tendencave globale drejt digjitalizimit dhe për t'iu përgjigjur më mirë krizës së shkaktuar nga Covid-19, janë bërë shumë investime dhe përmirësime të proceseve gjatë vitit 2020. Këto aktivitete u drejtuan kryesisht në zbatimin e planeve strategjike të digjitalizimit të mëtejshëm të bankës, përmirësimin e përvojës së klientëve, rritjen në maksimum të aftësive të bankës dhe transformimin e mënyrës së funksionimit të bankës. Prandaj, banka ka investuar vazhdimisht gjatë vitit 2020 dhe i njëjti trend i rritur parashihet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2021, shoqëruar me trajnimin e fuqisë punëtore të bankës të cilët pritet t'i tejkalojnë pritjet e klientëve nga banka.

Duke marrë parasysh të gjitha arritjet dhe suksesin e shënuar në vitin 2020, banka jonë në Kosovë u vlerësua si Banka më e Mirë në Kosovë për vitin 2020 nga The Banker. Banka e ka marrë çmimin për shkak të rritjes që banka e ka arritur në të gjitha aspektet e Bilancit të gjendjes dhe pasqyrës së të ardhurave gjatë vitit 2020, dhe për shkak se ka arritur t'i konceptojë, lansojë dhe operojë zgjidhjet më inovative në lidhje me praktikat bankare digjitale, e gjithë kjo me gjithë konkurrencën e fortë në sektorin bankar, me gjithë kufizimet rregullative në bankingun elektronik dhe më e rëndësishmja, me gjithë aktivitetet e ndaluara gjatë pandemisë.

BKT Kosova synon ta ruajë rritjen e qëndrueshme në vitin 2021 dhe në të ardhmen. Banka është duke i transformuar të gjitha proceset dhe duke i bërë ato më të orientuara drejt klientit dhe më efikase. BKT do të vazhdojë të jetë pioniere e inovacionit digjital në të gjithë tregun dhe do ta udhëheqë tregun në këtë aspekt.
Duke vënë në dukje të gjitha arritjet gjatë vitit 2020, ne, Bordi i Drejtorëve, jemi shumë mirënjohës për angazhimin dhe përkushtimin nga secili punonjës i bankës, secili nga klientët e bankës dhe të gjitha palët e lidhura, ndërsa ne e dedikojmë përkrahjen tonë për Menaxhmentin Ekzekutiv të bankës për realizimin e mëtejshëm të planeve strategjike për rritje dhe zhvillim.

Me respekt,
Z. Mehmet Usta
Kryesues i Bordit



SUAT BAKKAL

Mesazhi i Kryeshefit Ekzekutiv

BKT Kosova ka filluar transformimin e saj që nga viti 2018. Strategjia është përqendruar kryesisht në digjitalizimin e shërbimeve bankare konvencionale, të cilat nga njëra anë do ta rrisnin efikasitetin e bankës në ofrimin e shërbimeve, ndërsa nga ana tjetër, do t'i përmbushnin pritjet e klientëve dhe do ta rrisnin kënaqësinë e tyre. Pandemia e vërtetoi prapë që banka duhet ta zhvillojë më tej strategjinë e saj të digjitalizimit dhe automatizimit, prandaj banka është shumë e përkushtuar për t'u përmirësuar në këtë drejtim.

Duke marrë parasysh ritmin e shpejtë të automatizimit dhe digjitalizimit, fillimi i pandemisë në vitin 2020 e gjeti BKT Kosovën të përgatitur për menaxhimin e masave të bllokimit, pasi banka ishte e gatshme t'i ofronte shumicën e shërbimeve të saj nga distanca. Ndër shumë masa të marra për ta parandaluar përhapjen e Covid-19, BKT Kosova hartoi dhe zbatoi një program efikas të menaxhimit të krizës i cili paraqet konceptin, përgatitë dhe boton vazhdimisht material të gjerë komunikimi kushtuar vetëdijesimit të publikut. Këtu përfshihen udhëzimet ditore të ofruara përmes kanaleve të ndryshme, të tilla si TV, Media Sociale, Uebfaqe dhe degë.

Suksesi i bankës gjatë vitit 2020 bazohet në aftësinë e institucionit për ta përkrahur ekonominë e Kosovës, si bankë universale, me një larmi të plotë të zgjidhjeve bankare të nivelit botëror, si për bizneset ashtu edhe për individët. BKT Kosova është një nga bankat me rritjen më të shpejtë në tregun e Kosovës dhe mban ritmin më të shpejtë dhe më inovativ të digjitalizimit në industrinë bankare të vendit dhe kjo tendencë parashihet të vazhdojë edhe më tej.

BKT Kosova ka shënuar një vit të pasuruar me aplikacione të ndryshme, shërbime dhe produkte të konsideruara si depërtime të reja në tregun vendor. Llogaria digjitale, kredia digjitale, kredia përmes palëve të treta, Agro Dritarja dhe Smart Invest janë disa nga investimet më inovative që BKT Kosova i filloi gjatë vitit 2020, të gjitha këto të harmonizuara drejt arritjes së qëllimit kryesor të bankës, që është të jetë pranë klientëve në çdo mënyrë që ata e preferojnë, qoftë fizikisht apo në formë digjitale, duke i ofruar të gjitha llojet e shërbimeve dhe zgjidhjeve bankare.

Përveç kësaj, një nga aspektet më të vështira gjatë kësaj kohe, ishte bllokimi i përgjithshëm, ku banka u detyrua ta organizonte punën nga distanca për shumicën e punonjësve. Duke marrë parasysh shërbimet e digjitalizuara të bankës dhe proceset e automatizuara të cilat ishin zbatuar qysh më parë, organizimi i punës nga shtëpia është zhvilluar me lehtësi dhe në mënyrë efektive. Gjithashtu u dëshmua të jetë mjaft efikase në drejtim të përmbushjes së detyrave të përgjithshme dhe rritjes së kënaqësisë së klientit gjatë këtyre kohërave të trazuara.

Në çdo aspekt të aktiviteteve të bankës, u realizuan disa projekte të rëndësishme. Ndryshimi në mendësinë e fuqisë punëtore të BKT-së dhe përmirësimet e nxitura nga linjat e biznesit dhe të gjitha funksionet tjera mbështetëse të organizatës, përfundimisht filluan të japin rezultate të frytshme. Rezultati i fillimit të vitit për digjitalizimin e bankës, jo vetëm që pati si rezultat një rritje të ndjeshme të kënaqësisë së klientit, ajo u pasqyrua edhe në shifra financiare. Vëllimet e biznesit, numrat e transaksioneve, të ardhurat dhe cilësia e shërbimit, të gjitha shënuan rritje të konsiderueshme gjatë gjithë vitit.

Në mënyrë që të lehtësohet drejtimi strategjik i bankës, struktura organizative e bankës është përshtatur duke formuar ekipe specifike të detyrave, përgjithësisht të dedikuara për digjitalizimin dhe përdorimin e shërbimeve. Në këtë kontekst, një ekip kolegësh janë angazhuar në një departament të ri të quajtur Sistemet e Pagesave dhe Bankingu Digjital, ndërsa një departament i riorganizuar i Menaxhimit të Marrëdhënieve me Klientë mori përsipër zhvillimin e produkteve dhe shërbimin ndaj klientit të kombinuar me Njësinë e Komunikimit të Korporatës, qëllimi kryesor i të cilit ishte t'i pranonte dhe kuptonte pritjet nga klientët, për t'i personalizuar dhe zbatuar zgjidhjet bazuar në njohuritë për sjelljet e klientit dhe në fund, për t'i komunikuar këto zgjidhje publikut të gjerë dhe palëve të interesuara. Përveç kësaj, u formua një departament i dedikuar Bankingut Privat në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i marrëdhënieve me klientët individë me të ardhura neto të larta.

Një ekip i tërë u themelua për t'i analizuar dhe rindërtuar të gjitha proceset e brendshme të bankës. Ekipi bashkëpunon ngushtë me një kompani të jashtme, e cila konsultohet për trendet moderne të proceseve të brendshme të institucioneve financiare. Detyrat dhe objektivat kryesore të ekipit lidhen me analizimin e proceseve aktuale të brendshme dhe zbulimin e pengesave, të cilat më pas propozohen të zëvendësohen me rrjedha të reja të proceseve të cilat pritet të sjellin efikasitet për bankën dhe kënaqësi për punonjësit dhe klientët.

Duke shënuar ritmet më të larta të rritjes gjatë tri viteve të fundit radhazi në Kosovë, dhe duke marrë parasysh rritjen dhe zhvillimin e fortë, cilësor dhe premtues gjatë vitit 2020, suksesi i BKT Kosova u njoh ndërkombëtarisht. BKT Kosova operon me fokus të vendosur në përmirësimin e shërbimit të saj për klientë me qëllim që të ofrojë qasje në shërbime bankare për të gjithë dhe kudo, si për bizneset ashtu edhe për individët. Si e tillë, BKT Kosova është shpërblyer me çmimin prestigjioz Banka e Vitit 2020 për Kosovë nga The Banker, që është revistë financiare që publikohet nga The Financial Times, dhe ky sukses u atribuohet klientëve, punonjësve dhe palëve tjera të interesuara të bankës.

Me respekt,
Z. Suat Bakkal
Drejtor Ekzekutiv dhe Anëtar i Bordit



MEHMET USTA
Kryetar Bordi



SEYHAN PENCABLIGLI
Zëvendës Kryetar Bordi



MERT TURGUT ÇALIK
Anëtar Bordi



ABDURRAHMAN BALKIZ
Anëtar Bordi



AYŞEGÜL ADACA OĞAN
Anëtare e Bordi



GALIP TÖZGE
Anëtar Bordi



GÜROL GÜNGÖR
Anëtar Bordi



SUAT BAKKAL
Kryeshef Ekzekutiv dhe
Anëtar Bordi



SUAT BAKKAL

Kryeshef Ekzekutiv dhe
Anëtar Bordi



ALBION MULAKU

Drejtues i Grupit të Bankingut
për Biznese dhe Korporata



NJOMZA BUXHOVI AHMETAJ

Drejtuese e Grupit të Bankingut Individual



MUHARREM INAN

Drejtues i Grupit të Thesarit, Institucioneve
Financiare dhe Bankingut Privat



ELTON XHAFAJ

Drejtues i Grupit të Auditimit
të Brendshëm



NAIM RATKOCERI

Drejtues i Grupit të Menaxhimit
të Kredive dhe Ligjore



AGON SKEJA

Djretues i Grupit të Financave dhe
Administratës



Shitja përmes degës

Pandemia gjatë vitit 2020 ka pasur ndikim masiv në të gjithë globin dhe në çdo aspekt jetësor. COVID-19 padyshim që ka pasur gjithashtu një ndikim të rëndësishëm në bankat në përgjithësi.

Pavarësisht nga rihapja e vazhdueshme në të gjithë vendin, ndërprerja e zgjatur e lidhur me COVID-19 dhe dëmtimet në rritje të bizneseve me pakicë kanë krijuar shumë pasiguri ku shumë shpejt bankat duhet të rifillojnë operacionet normale në degë.

Stafi i degëve ka qëndruar në vijë të parë duke ofruar shërbime thelbësore dhe produkte të njëjta gjatë gjithë pandemisë.

Në vazhdimësi pritjet e klientëve për bankat po shkonin drejt zhvillimit të digjitalizimit dhe pandemia vetëm sa e ka përshpejtuar këtë gjë.

Gjatë vitit 2020, BKT ishte banka e parë ne tregun kosovar që u ofroi klientëve llogari digjitale dhe kredi digjitale. Nga data e lansimit të kredisë digjitale, nga gushti i vitit 2020, ka pasur numër të konsiderueshëm të aplikimive për këtë produkt, i cili gjatë vitit 2020 ka gjeneruar një portfolio të re kredie në shumë prej më shumë se 500,000 euro.

Gjatë kësaj kohe, banka ishte mjaft aktive edhe me oferta dhe promocione për produkte tjera gjithashtu. Përkundër shmangies së kontakteve fizike me klientë, informatat rreth produkteve dhe shërbimeve janë shpërndarë tek klientët në mënyra alternative (SMS, e-mail, thirrje telefonike, etj). Në këtë mënyrë është zhvilluar në përgjithësi komunikimi alternativ, pa u ndalur zhvillimi i biznesit në kushte të jashtëzakonshme.


Kujdes i veçantë u është kushtuar klientëve të depozitave, kryesisht atyre që jetojnë jashtë vendit, duke iu mundësuar që të bëjnë ripërtëritjen e kontratave të depozitave me një konfirmim përmes e-mailit.

Është arritur të përçohet një siguri tek klientët se mjetet e tyre janë të sigurta dhe më pastaj edhe të arrihet një rritje rekorde në depozita prej 64.5 milionë euro.

Po ashtu, mundësia e edukimit të klientëve sa i përket përdorimit te shërbimeve digjitale është një çështje e rëndësishme që është aplikuar gjatë vitit 2020. Viti 2020 i ka dhënë mësim bankës që sistemi tradicional i punës është kthyer në favor të qartësisë dhe shkathtësisë për të trajtuar çrregullimet e paparashikuara të tregut.

Këto mësime i kanë hapur bankës një rrugë të re të punës.





Shitja përmes tregtarëve

Në vazhdën e inovacioneve të reja gjatë vitit 2020, BKT Kosova ofroi edhe një risi në tregun bankar Kosovar, duke qenë më afër klientëve të saj dhe duke krijuar kanalin më inovativ të shitjes, atë që banka e quan Shitja përmes Tregtarëve (Merchant Sales). Në linjë me këtë, banka ka themeluar Departamentin e Shitjes përmes Tregtarëve, i cili synon që klientëve të bankës t'u ofrojë mundësi unike në treg për të bërë kërkesë për kredi konsumatore drejtpërdrejt tek partnerët e bankës, pa pasur nevojë të vizitohet banka për këtë arsye. Po ashtu, Departamenti i shitjes përmes tregtarëve ofron mundësinë që klientët e bankës të marrin përgjigje për miratimin e kredisë për 20 minuta, sërish pa vizituar bankën dhe pa komunikuar me punonjësit e bankës.

Në vitin 2020 pandemia pati ndikim negativ në rrafsh global, andaj përkundër situatës së krijuar nga pandemia, Departamenti i Shitjes përmes Tregtarëve krijoi partneritet me kompani të industrive të ndryshme, duke filluar nga industria e shitjes së veturave, industria e ndërtimit dhe shitjes së hapësirave për banim dhe industria e mobileve dhe pajisjeve të tjera shtëpiake.

Ky partneritet rezultoi me gjenerimin e një portfolioje kredie prej 4.2 milionë euro, të miratuara përmes kanalit të shitjes me lokacion në zyrat e tregtarëve partnerë të bankës.
Departamenti me përkushtim të jashtëzakonshëm është i angazhuar që lidhja me tregtarët të jetë në nivel profesional e bazuar në besueshmëri, në komunikim sa më efikas, dhe në zgjerim të rrjetit të partnerëve në tërë territorin e Kosovës.

Numri i përdoruesve u rrit për **43%**

Përdoruesit aktivë arritën në **60%**

Numri i transaksioneve u rrit për **40%**

Vëllimi i transaksioneve u rrit për **37%**

Një vështrim mbi digjitalen

Pandemia COVID-19 ka përshpejtuar procesin e bankingut digjital falë shumë përfitimeve që sjellë ky i fundit. Bankingu digjital ndihmoi në zvogëlimin e nevojës që qytetari të shkojë fizikisht në bankë dhe fizikisht të kryejë transaksione. Ai gjithashtu u ofroi qytetarëve qasje më të sigurt në banking dhe ua kurseu kohën.

Përdorimi i celularëve të mençur është rritur relativisht shumë gjatë pandemisë COVID-19. Për më tepër, shërbimet bankare 24/7 dhe bankingu i lehtë përmes celularit kanë ndihmuar në lulëzimin e bankingut digjital.

Banka u ka ndihmuar klientëve që të ndjehen të sigurt gjatë një kohe pasigurie duke iu ofruar këshilla, dhe të kryejnë transaksione bankare kur dhe si ata dëshirojnë.


Ndikimi i pandemisë në jetën e përditshme të bankës i ka shtyrë shumë prej klientëve të ndryshojnë mënyrën se si i menaxhojnë financat e veta, ku është vërejtur se bankingu dixhital ka shënuar rritje të jashtëzakonshme.

Të kuptuarit e nevojave - Zhvillimi i zgjidhjeve

Në vitin 2020 banka u përqendrua në ri-dizajnimin e përvojës bankare dhe në inkuadrimin e klientëve në shërbimet e saj në mbarë platformat, dixhitale dhe atë fizike, për të përmbushur nevojat dhe pritjet e klientëve. Investimet e bëra si përgjigje ndaj pandemisë i mundësuan bankës përshpejtim të realizimit të strategjisë së bankingut dixhital.

Aplikacionet digjitale janë përmirësuar me karakteristika të reja e opsione vetë-shërbyese të tilla si:

- **Hapja e llogarisë digjitale**
- **Kredia digjitale**
- **Kartela digjitale e kreditit**
- **Bankingu përmes IVR-së dhe telefonit**





Covid 19 - Ndikimi në BKT

Në mënyrë që banka të mund t'i përgjigjet tregut dhe tendencave globale drejt digjitalizimit dhe për t'iu përgjigjur më mirë krizës së shkaktuar nga Covid-19, janë bërë shumë investime dhe përmirësime të proceseve gjatë vitit 2020. Këto ndërmarrje u drejtuan kryesisht në zbatimin e planeve strategjike të digjitalizimit të mëtejshëm të bankës, përmirësimin e përvojës së klientit, rritjen në maksimum të aftësive të bankës dhe transformimin e mënyrës së funksionimit të bankës. Prandaj, banka ka investuar vazhdimisht gjatë vitit 2020 dhe i njëjti trend i rritur parashihet të vazhdojë edhe gjatë vitit 2021, shoqëruar me trajnimin e fuqisë punëtore të bankës të cilët pritet t'i tejkalojnë pritjet e klientëve nga banka.

Në përputhje me masat e qeverisë dhe në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Banka Qendrore, BKT Kosova ka krijuar dhe ofron zgjidhje të lehta për klientët për aktivitetet e tyre bankare. Llogaria digjitale ishte një vendim i domosdoshëm nga banka, duke marrë parasysh pritjet e klientëve dhe situatën e re të krijuar si rezultat i pandemisë. Pasi qeveria shpalli pakon e saj të përkrahjes financiare për pjesën më të ndjeshme të qytetarëve, dhe duke pasur parasysh se një numër i madh i këtyre klientëve nuk kanë llogari bankare, BKT Kosova vendosi ta thjeshtojë procesin e hapjes së llogarive, duke ofruar qasje të lehtë, të sigurt dhe të shpejtë në shërbimet bankare për çdo qytetar të interesuar. Hapja e llogarisë digjitale nga distanca u ndihmoi klientëve dhe bankës në dy ngjarje kryesore që u organizuan nga qeveria, si pakoja financiare për t'u ndihmuar qytetarëve gjatë pandemisë dhe tërheqja e një pjese të kontributit pensional.

Qeveria e Kosovës doli me një pako të ndihmës financiare për qytetarët të cilët u prekën më së shumti nga pandemia, veçanërisht gjatë tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2020. Kjo masë u mirëprit nga qytetarët, megjithatë doli se shumë njerëz nuk kishin llogari rrjedhëse aktive në bankë. Duke marrë parasysh që këto fonde do të shpërndaheshin vetëm përmes llogarive bankare, bankat u vërshuan nga klientët të cilët dëshironin të hapnin llogari, me gjithë masat e rrepta anti-Covid dhe bllokimin. BKT Kosova ishte banka e parë në treg që filloi hapjen digjitale të llogarisë rrjedhëse, e cila bëhej në mënyrë shumë të shpejtë dhe të thjeshtë. Klientët kanë aplikuar online për llogari, ndërsa Njësia e Shërbimit për Klientë e bankës i ka kontaktuar ata për ta kryer procesin e kujdesit të duhur dhe bëri hapjen e llogarisë në distancë. Kjo ka krijuar një përparësi konkurruese dhe një proces të mirë të përkrahjes për klientët që nuk u lejohej të dilnin jashtë. Shumë klientë hapën llogaritë dhe morën pagesa nga qeveria, pa pasur nevojë ta vinin në rrezik shëndetin e tyre duke u ekspozuar ndaj infeksionit.

Ngjashëm me procesin e lartpërmendur, qeveria vendosi t'u lejojë qytetarëve të tërheqin 10% të kontributeve të tyre pensionale nga Trusti Pensional i Kosovës si masë për t'u ndihmuar atyre ta rrisin rrjedhën e parave dhe fuqinë e tyre blerëse gjatë pandemisë. Duke marrë parasysh që shumë punonjës në Kosovë nuk kishin llogari rrjedhëse bankare për t'i tërhequr paratë, ata patën nevojë ta hapnin një llogari bankare. I njëjti proces i ndërmarrë për ndihmën qeveritare, u zbatua edhe për tërheqjen e pensioneve nga Trusti, kështu që banka u mundësoi klientëve të hapin llogari digjitale dhe të aplikojnë për tërheqjen e fondeve pa pasur nevojë ta vizitojnë bankën.

Ndër shumë gjëra "të para dhe më të mira" të zbatuara gjatë vitit 2020, përfshijnë:



Llogaria digjitale: Lansimi i Llogarisë Digjitale ishte vendim i domosdoshëm nga banka, duke marrë parasysh pritjet e klientëve dhe situatën e re të krijuar si rezultat i pandemisë. Pasi qeveria shpalli pakon e saj të përkrahjes financiare për pjesën më të ndjeshme të qytetarëve, dhe duke pasur parasysh se një numër i madh i këtyre klientëve nuk kanë llogari bankare, BKT Kosova vendosi ta thjeshtojë procesin e hapjes së llogarive, duke ofruar qasje të lehtë, të sigurt dhe të shpejtë në shërbimet bankare për çdo qytetar të interesuar. Hapja e llogarisë digjitale nga distanca u ndihmoi klientëve dhe bankës në dy ngjarje kryesore që u organizuan nga qeveria, si pakoja financiare për t'u ndihmuar qytetarëve gjatë pandemisë dhe tërheqja e një pjese të kontributit pensional.

Kredia digjitale: BKT Kosova ka shkuar një hap më tutje në konceptimin, zhvillimin dhe zbatimin e mundësive tjera bankare online, në mënyrë që misioni i bankës për të ofruar mundësi bankare të materializohet më tej, veçanërisht gjatë kohës kur lëvizja e lirë e qytetarëve është e kufizuar dhe aktivitetet sociale janë ndërprerë. Në këtë kontekst, për herë të parë në industrinë bankare të Kosovës, BKT Kosova prezantoi Kredinë Digjitale përmes bankingut në telefon celular dhe Llogarinë Digjitale që mund të hapet online për ata që janë prekur më së shumti nga pandemia. Individët mund t'i hapin llogaritë e tyre rrjedhëse duke aplikuar në internet dhe me një klikim, pa pasur nevojë t'i vizitojnë degët. Pasi klientët të aplikojnë, ata i marrin të gjitha detajet e lidhura me llogarinë përmes emailit dhe kjo u ndihmon atyre të kursejnë kohë, të jenë më efikas dhe të kenë qasje në shërbimin bankar nga distanca dhe në çdo kohë. Banka ka lansuar Kredinë Digjitale, e cila është produkti më i ri në bankë dhe deri më tash i pari në tregun e Kosovës. Ajo synohet për të gjithë klientët e BKT-së të cilët mund të aplikojnë 24/7 përmes aplikacionit bankar në telefon celular për kredi personale për investime personale, në një proces që përfundon brenda 4 hapave dhe 5 minutave, duke marrë përgjigjen e miratimit ose refuzimit menjëherë.

Rrjeti i tregtarëve: Pavarësisht përqendrimit të bankës në digjitalizimin e kanaleve të shërbimit dhe transaksioneve bankare, kontakti njerëzor mbetet thelbësor, jo vetëm në aspektin e zgjerimit të mundësive të biznesit, por edhe në aspektin e ruajtjes dhe përmirësimit të menaxhimit të marrëdhënieve me klientin. Një numër i madh i klientëve i vlerësojnë lokacionet fizike të bankës dhe afërsinë e tyre, në mënyrë që të kryejnë veprime bankare shpejt dhe lehtë. Në mënyrë që të mund të ofrojë një numër të madh të pikave të shërbimit për klientët e bankës, ndërsa duke qenë efektive në menaxhimin e kostove sa u përket investimeve, banka ka nënshkruar partneritete me institucione financiare jo-bankare (p.sh. agjencitë e transferimit të parave), ku klientët mund të marrin shërbim sikur të ishin duke vizituar degët e vërteta të bankës. Në këtë kontekst, agjencitë e kontraktuara, të cilat janë të vendosura në të gjithë territorin e Kosovës, aktualisht ofrojnë shërbime të ndryshme bankare në emër të bankës, siç janë depozitimi dhe tërheqja e fondeve, aplikimi për produkt kreditor (kredi, kredit kartelë ose mbitërheqje) ose shërbime tjera të lidhura me llogaritë. Me anë të kësaj mase të thjeshtë të ndërmarrë dhe promovuar nga banka, rrjeti i pikave fizike të shpërndarjes së bankës është trefishuar, ndërsa kostot fikse dhe të ndryshueshme të bankës sa i përket rrjetit, kanë mbetur të pandryshuara. Më e rëndësishmja është që, përveç që është në dispozicion 24/7 për klientët përmes platformave online të bankës, banka tani ofron rrjetin më të madh dhe më efikas të degëve dhe agjencive që nxit strategjitë e blerjes, arrin pritjet e klientëve dhe rrit kënaqësinë e përgjithshme në kryerjen e transaksioneve bankare.

Kreditë e tregtarëve: Zhvillimet e strategjisë së inovacionit, duke u bërë më "të përshtatur për huamarrësin" dhe duke konkurruar për të marrë klientë të rinj, e kanë nxitur BKT-në drejt zhvillimit të kanaleve të reja që e dallojnë bankën nga konkurrentët dhe mundësojnë financimin e klientëve përmes një marrëdhënieje të ndërmjetësisë së palës së tretë.



Në mënyrë që të zgjerohen mundësitë afariste të shitjes së produkteve kreditore, është zhvilluar një kanal i ri përmes partnerëve tregtarë duke u mundësuar klientëve potencialë dhe ekzistues të marrin financim përmes marrëdhënieve të palëve të treta. Zhvillimet në teknologji janë përmirësuar deri në atë pikë ku tregtarët që më parë mund të kenë pranuar vetëm para të gatshme ose kredit kartela tani mund ta ofrojnë mundësinë e kredisë në momentin e blerjes. Duke u mundësuar klientëve të marrin financim përmes marrëdhënieve me palë të treta, BKT i ka zgjeruar ofertat e saj në një gamë më të gjerë të klientëve të rinj dhe ekzistues nga shumë marrëdhënie, tregtarë dhe shitje me pakicë që merren me gjëra të mëdha si pasuri të paluajtshme dhe makina, deri në gjëra më të vogla të tilla si mobile dhe teknikë të bardhë/hirtë/kafe. Për shkak të rrjetit të gjerë të tregtarëve, BKT ofron më shumë mundësi për klientët, që të financohen nga një gamë më e gjerë e huamarrësve për shkak të marrëdhënieve të tyre të rrjetit dhe t'i shërbejnë klientit në një vend dhe me qasje të lehtë në financim. BKT ka arritur një numër të konsiderueshëm të marrëveshjeve me shitësit e automjeteve, duke mbuluar 90% të tregut të makinave të reja.

Dërgesat (Remitencat): Për shkak të numrit të rregullt dhe të lartë të dërgesave që vijnë nga diaspora në Kosovë, BKT e ka rritur numrin e kanaleve të dërgesave duke ofruar shërbime nga dy kompani dhe bankë postare në Zvicër. Ndërkohë, BKT u ofron klientëve tani mundësinë për të bërë pagesa ndërkombëtare në 125 valuta përmes një produkti të veçantë të dizajnuar.

Depozita Avans: Të njëjtit klientë që kanë aplikuar online, tani u është dhënë mundësia të aplikojnë për llogari depozite të afatizuar në avans. Depozita e afatizuar ofrohet për 6 muaj ose 12 muaj maturitet, me një normë atraktive interesi, që kreditohet në llogarinë rrjedhëse të klientit menjëherë, që do të thotë që klienti shpërblehet paraprakisht me kamatë, ndërsa kryegjëja e tij e shumës së depozituar mbetet e paprekur deri në maturimin e kontratës. Duke marrë parasysh situatën aktuale, kur klientë të ndryshëm kanë prirje të shpenzojnë më shumë nga kursimet e tyre, ky produkt del në pah, pasi klientëve u jepet mundësia ta hapin një depozitë të afatizuar, e cila nga njëra anë i ndihmon ata të kursejnë para për të ardhmen, ndërsa nga ana tjetër, banka ua jep interesin në fillim, i cili vihet në dispozicion për shpenzim.

Smart Invest: Kur kemi parasysh inovacionet dhe lansimin e produkteve të reja, BKT ka prezantuar platformën e saj të investimeve "Smart Invest" në organizimin për klientë në fundvit më 19 dhjetor 2019. Banka e konsideron veten të privilegjuar që është pionier i fillimit të platformës së parë dhe të vetme lokale të investimeve, e cila i hapi dyert për qytetarët e Kosovës për të hyrë në tregjet financiare ndërkombëtare ose për t'i mbrojtur nga rreziqet e aseteve të tyre financiare. "Smart Invest" u jep klientëve qasje të drejtpërdrejtë në produkte të ndryshme si FX, mallra dhe aksione, jo vetëm në tregjet e nivelit më të lartë si SHBA, Gjermania, Japonia ose MB, por edhe në Afrikën e Jugut, Peru dhe shumë tregje të tjera, ku mund të tregtojnë me investitorë ndërkombëtarë. Vetë platforma u ofron klientëve






qasje të drejtpërdrejtë dhe të lehtë për përdoruesit, që do të thotë se ata mund ta kryejnë çdo investim vetë në mënyrë të pavarur, pa pasur nevojë të paraqesin kërkesa në bankë. Klientët e interesuar mund të kryejnë investime me një klikim me çmimet më të mira të tregut duke përdorur platformën "Smart Invest", qoftë përmes e-banking ose bankingut me celular. "Smart Invest" u mundëson klientëve t'i monitorojnë tregjet në telefonin e tyre, ku ata edhe mund të lexojnë lajme përkatëse të çastit, të marrin njoftime, të vendosin urdhra dhe të bëjnë analiza teknike. Përveç kësaj, klientët mund ta shohin historinë e investimeve të tyre, analizën e performancës, lëvizjet e llogarive dhe shumë më tepër informata me transparencë të plotë.

Kondor: BKT Kosova ka ndërmarrë projektin "Kondor" për ta rritur automatizimin në proceset e Thesarit. Kjo platformë ku janë të regjistruara të gjitha produktet e Thesarit, përdoret edhe nga bankat ndërkombëtare. Platforma mundëson procesimin e drejtpërdrejtë të "STP" për transaksionet e kryera në platformat ndërkombëtare. Kufijtë e mëposhtëm përcaktohen në platformë në mënyrë që departamentet përkatëse të mund të njoftohen dhe monitorojnë automatikisht limitet e shteteve, limitet kreditore dhe të shlyerjes së palës tjetër, limitet e pozicionit, limitet e ndalimit të humbjes dhe limitet e përdoruesit. Meqenëse produkti është i lidhur me platforma ndërkombëtare si Bloomberg dhe Reuters, ai i llogarit vlerat "MTM" krahason me tregun dhe matje tjera të rrezikut në baza ditore. Kjo platformë e thesarit ndihmon rritjen e efikasitetit në mënyrë të konsiderueshme falë automatizimit të shumicës së proceseve duke përfshirë funksionet e kontabilitetit, zyrës mbështetëse, kontrollit dhe rrezikut.

Sistemi IVR: Gjatë vitit 2020 banka lansoi shumë zgjidhje dhe produkte të reja, megjithatë, aplikacionet e reja të sjella në bankë si depërtime të reja në treg lidhen me procesin e shërbimit ndaj klientit. IVR dhe Bankingu Telefonik janë aplikacionet e reja të instaluara në qendrën e kontaktit, që u mundësojnë klientëve të informohen për pasqyrat e tyre bankare dhe të kryejnë transaksione të ndryshme bankare pa pasur nevojë të flasin me ndonjë agjent. I tërë bankingu mund të kryhet duke përdorur kredencialet e kartelës bankare të klientit dhe tastierën e telefonit të tyre celular.

Sistemi i ankesave: Një aplikacion tjetër ka të bëjë me menaxhimin e ankesave të klientëve, i cili u ndihmon punonjësve përgjegjës të bankës ti menaxhojnë më mirë kërkesat dhe ankesat e ndryshme nga klientët, sipas procedurave të brendshme më efektive dhe në përputhje me kërkesat rregullative. Pjesa më e madhe e procesit të menaxhimit të ankesave është e organizuar në mënyrë të automatizuar, që vazhdimisht u ofron klientëve dhe stafit sinjale dhe njohuri për zgjidhjen e ankesave.





11 Grupi i Bankingut të Korporatave dhe Bizneseve





Kontributi ynë shkon përtej ekonomisë së vendit tonë, ne punojmë për një të ardhme të ndritur për Kosovën

Viti 2020 për Grupin e Bankingut të Korporatave dhe Bizneseve ishte planifikuar shumë ambicioz dhe me synime dhe objektiva të ndryshme. Megjithatë, për shkak të paraqitjes së papritur të pandemisë, të gjithë sektorët u prekën dhe kjo e preku edhe sektorin bankar. Prapë, sektori bankar mbeti përkrahës për bizneset, duke ofruar qasje të ndryshme për shtyrjen e kësteve ose ri-strukturimin e borxhit të tyre në mënyrë që bizneset ta tejkalojnë lehtësisht situatën e krijuar gjatë pandemisë.

Grupi i Bankingut të Korporatave dhe Biznesit, përkundër pandemisë, arriti të ruajë një rritje të konsiderueshme të kredive të përgjithshme të biznesit dhe portfolios së depozitave të biznesit. Ndërsa tregu i përgjithshëm i kredive për biznese u rrit për ~ 8.53%, portfolio e kredisë për biznese në BKT u rrit për ~ 18%. Rrjedhimisht banka arriti ta rrisë pjesën e tregut në kreditë e biznesit nga ~ 10% gjatë vitit 2019 në 11.2% në 2020. Gjithashtu, trendi pozitiv vazhdoi edhe për depozitat e biznesit, ndërsa BKT arriti ta rrisë portfolion e depozitave me 17.5% dhe pjesëmarrja e tregut për depozita arriti në 12.6%. Cilësia e portfolios së kredive është prioritet për grupin e biznesit, përveç rritjes së portfolios, përqindja e kredive jo-performuese mbetet nën nivelin e përgjithshëm të KJP-ve në sektor.

Qasja e grupit të biznesit të BKT-së për vitin 2020 ishte kryesisht ruajtja e partneritetit me klientët ekzistues, që do të thotë se ata do ta marrin përkrahjen e nevojshme për shkak të situatës së krijuar si rezultat i Covid-19. Përkrahja është e krijuar për të gjitha segmentet e biznesit qofshin ato NVM, Mikro apo segmente tjera biznesi.

Gjatë pandemisë, banka kishte fokus të veçantë financimin dhe përkrahjen e sektorit të bujqësisë, veçanërisht bujqit dhe agro bizneset, në mënyrë që t'u ndihmojë atyre t'i rrisin kapacitetet e tyre dhe ta tejkalojnë situatën e pandemisë. Rëndësi e madhe iu dha këtij sektori duke ofruar një gamë të gjerë të produkteve për t'u mundësuar këtyre bizneseve që të zhvillohen më shumë dhe të kontribuojnë në ekonominë e përgjithshme të vendit.


Në vitin 2020 u përdor Agro Dritarja nën limitin e Fondit të Garancive të Kosovës dhe u rrit në mënyrë që të lehtësohej qasja në financa për bujqit dhe agro-bizneset. Banka vazhdoi ta financojë zinxhirin e vlerës për sektorin e bujqësisë duke zgjeruar rrjetin me partnerë tjerë dhe në krijimin e produkteve të reja të tilla si kredi për financimin e pajisjeve, kutitë e magazinimit, etj.

Përkrahja për bizneset vazhdoi në disa fusha, marrëveshjet dhe projektet vazhduan në vitin 2020 të tilla si: marrëveshja me komunat për financimin e agro dhe mikro klientëve, projekti për prodhimin e produkteve qumështore për financimin e rrjetit të tyre të furnizuesve (ferma më të vogla dhe fermerë individualë) që pati ndikim pozitiv në mirëqenien e bujqve në përgjithësi duke i rritur të ardhurat e tyre.

Biznesi i financimit të tregtisë është segment i rëndësishëm në biznesin e përgjithshëm të grupit, prandaj banka vazhdoi ta ketë një pjesë të qëndrueshme të tregut në këtë kategori, dhe deri në fund të vitit 2020 banka mori pjesë me 12% në financat tregtare (LG&LK) në treg. Për të gjithë partnerët afaristë të bankës që i ndryshuan aktivitetet e tyre për shkak të Covid 19 dhe kishin nevojë për garanci në aktivitetet e tyre afariste, Banka ishte në dispozicion për t'i financuar ata në mënyrë që t'u ndihmonte ta mbajnë biznesin e tyre gjatë këtyre kohëve.

Grupi i Bankingut të Korporatave dhe Biznesit ka investuar vazhdimisht në digjitalizimin e shërbimeve. Për shkak të pandemisë, transaksionet në internet janë rritur me shpejtësi dhe u krijuan dhe azhurnuan kanale të reja për t'i lehtësuar transaksionet e klientëve. Kanalet alternative të bankingut të tilla si e-banking për biznese dhe bankingu përmes telefonit celular janë avancuar duke ofruar veçori shtesë në mënyrë që banka të krijojë fleksibilitet për klientët.

12 Grupi i Thesarit, Institucioneve Financiare dhe Bankingut Privat



Thesari dhe Institucionet Financiare

Qytetarët e Kosovës kanë tregtuar në tregjet ndërkombëtare në mënyrë tradicionale duke i kontaktuar bankat, gjë që i kufizon ata me orarin e punës. Kjo përbën rrezik të madh për menaxhimin e investimeve të tyre. Veçanërisht në kohë të jashtëzakonshme të pandemisë, ka qenë më e rëndësishme që klientët të kenë kontroll të drejtpërdrejtë mbi pozicionet e tyre. Në këtë drejtim, BKT ka qenë pioniere për ta ofruar platformën e parë lokale të investimeve, e cila mund të qaset përmes e-banking si dhe kanaleve bankare në celular, në çdo kohë. Përveç kësaj, banka e ka zhvilluar buletinin e parë ditor "Premier Daily" në gjuhën shqipe për t'u ndihmuar klientëve për vendimet e tyre të investimeve, duke marrë parasysh mungesën e burimeve të tilla në shqip.

Me rritjen e luhatshmërisë në tregjet financiare gjatë pandemisë, është bërë thelbësore të jemi në gjendje t'i monitorojmë rreziqet e bilancit. Banka ka vendosur një fokus të konsiderueshëm në menaxhimin e aseteve dhe detyrimeve për shkak të rritjes së kapitalit, normës së këmbimit valutor, normës së interesit dhe rreziqeve të likuiditetit. Në këtë aspekt, banka e ka finalizuar projektin për automatizimin e funksioneve të Thesarit sa i përket kontabilitetit, kontrollit dhe menaxhimit të rrezikut. Platforma e re i jep Departamentit të Thesarit lehtësinë e menaxhimit dhe monitorimit dinamik të bilancit gjatë kohërave të paqëndrueshme. Për më tepër, banka i ka përmbushur të gjitha kërkesat e klientëve në kohën e duhur në të gjitha valutat falë praktikave efikase dhe të qëndrueshme të menaxhimit të likuiditetit.

Menaxhimi i Remitencave

Duke qenë ekonomi e shtyrë nga konsumi, vendi ka nevojë për financim të jashtëm, i cili vjen përgjithësisht në formën e dërgesave të parave. Pas shpërthimit të pandemisë, rrjedha e dërgesave ka qenë më kritike për qëndrueshmërinë e ekonomisë. Ndërsa lëvizja ndërkombëtare u kufizua, diaspora duhej t'i përdorte kanalet bankare për bartjen e fondeve. Banka i ka rritur alternativat për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve në mënyra më të përshtatshme dhe më pak të kushtueshme. Meqenëse pjesa më e madhe e diasporës së Kosovës ndodhet kryesisht në Zvicër, klientëve të bankës iu ofrua një kanal i veçantë përmes njësisë së shërbimeve financiare të Swiss Post. Për më tepër banka ka ofruar larmi të kanaleve të pagesës, ku klientët mund të marrin dhe të dërgojnë një shumë të caktuar parash në një rrjet të madh lokacionesh përmes rrjetit RIA dhe UPT me kosto më të ulëta.


Njëkohësisht, banka është përqendruar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit për arritjen e kënaqësisë më të lartë të klientit. Në këtë drejtim, banka ka ndërmarrë një projekt për automatizimin e pagesave ndërkombëtare, i cili e mundëson edhe gjurmimin e destinacionit të pagesës.

Bankingu Privat

Banka ka themeluar Departamentin e Bankingut Privat me motivimin e ofrimit të shërbimeve të dalluara dhe të përmirësuara për klientët e saj. Duke shënuar normën më të lartë të rritjes në sektorin bankar në tri vitet e fundit, banka ka arritur një bazë të konsiderueshme klientësh. Prandaj, ishte e nevojshme të krijohet Departamenti i Bankingut Privat për të ofruar shërbime të personalizuara për një segment të caktuar të klientëve duke i dalluar produktet dhe shërbimet.

Në këtë aspekt, banka synon ta krijojë një strukturë të menaxhimit të portfolios në degë për ta rritur kënaqësinë e klientit duke e standardizuar një nivel të caktuar të shërbimit. Ky do të jetë një nga qëllimet në transformimin e ardhshëm të bankës.

13 Grupi i Menaxhimit të Kredive dhe Çështjeve Ligjore





Sipas Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), sektori bankar deri në shpërthimin e pandemisë Covid-19, operonte në një mjedis me nivel të ulët rreziku. Përhapja e pandemisë Covid-19, në gjysmën e dytë të marsit 2020 dhe masat e kufizimit të ndërmarra vazhdimisht, kanë ndikuar në rritjen e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar.

Në këtë aspekt, efekti i pandemisë Covid-19 do të ndikojë drejtpërdrejt në nivelin e kredive jo-performuese (KJP), që pritet të rritet edhe në periudhën vijuese, pasi aktualisht është në një nivel mjaft të ulët, pasi kjo do të ndikohet nga pandemia Covid-19 në ekonominë e Kosovës. Kjo është si pasojë e rënies së të ardhurave të familjeve, të ardhurave të bizneseve dhe aktiviteteve tjera ekonomike të ngadalësuara.

Pavarësisht nga rreziqet në rritje të shkaktuara nga pandemia Covid-19, treguesit e shëndetit financiar të sektorit bankar vazhduan të mbeten në nivel të kënaqshëm gjatë vitit 2020. Megjithëse KJP-të kanë shënuar rritje në krahasim me vitin e kaluar, duke mbyllur vitin 2020 me normën e KJP-ve ndaj gjithsej kredive me 2.7%, krahasuar me dhjetorin 2019 që ishte 2%, prapë niveli i tyre ndaj kredive totale vazhdon të jetë i ulët dhe ato janë provizionuar mjaft mirë kundrejt humbjeve të mundshme që mund të shkaktohen. Shkalla e KJP-ve ndaj kredive totale mbetet në nivel të ulët krahasuar me vendet e rajonit (Evropa Juglindore).

Aktiviteti i arkëtimit së bashku me fshirjet e kredive jo-performuese nga bilancet e bankave ndikuan në përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së portofolit kreditor. Një pjesë e efektit të rënies së KJP-ve u atribuohet edhe faktorëve tjerë si masat lehtësuese të BQK-së dhe vendimet për inkurajimin e bankave që ta marrin në konsideratë kërkesën e huamarrësit për mundësimin e periudhave të moratoriumit dhe ri-programimin e kredisë gjatë periudhës së rimëkëmbjes ekonomike për shkak të pandemisë Covid-19, duke e evituar angazhimin në likuidimin e kolateralit, duke përdorur mekanizma jashtë gjykatës.

Kështu, si rezultat i masave të shpejta dhe fleksibile të marra nga bankat në sektorin bankar për zbatimin e masave lehtësuese të kushteve të kredive sipas udhëzimeve të BQK-së, është kontribuar në aftësinë paguese të këtyre huamarrësve si dhe në praktikat më të mira të menaxhimit të rrezikut në banka. Si pasojë, këta faktorë dhe masa janë pasqyruar në burime më të ulëta të kredive jo-performuese dhe rimëkëmbjen e tyre gjatë periudhës.

Sa i përket BKT Kosova, cilësia e ekspozimeve kreditore ruhet dhe monitorohet përmes një procesi të kujdesshëm të identifikimit, menaxhimit dhe uljes së ekspozimeve kreditore për të gjithë segmentet dhe produktet e portfolios. Gjatë vitit 2020, Departamenti i Arkëtimit dhe Ri-programimit të Kredive është prekur nga fusha e detyrave dhe përgjegjësive, të cilat reflektojnë me masa dhe orar pune më proaktive dhe fleksibile, përfshirje dhe përkrahje të drejtpërdrejtë gjatë gjithë procesit për përmbushjen në nivel të lartë të kërkesave të huamarrësit për periudhat e moratoriumit dhe ri-programimet e kredive për shkak të pandemisë, si dhe aktivitetit më të lartë të monitorimit dhe arkëtimit, duke i përfshirë edhe degët në aktivitete të rregullta monitorimi. Gjithashtu gjatë këtij viti, vizitat në terren kanë qenë të kufizuara gjatë periudhës së bllokimit, ndërsa format tjera të kontaktit, komunikimet me klientët ishin në fokus të departamentit në mënyrë që të kishte reagim të hershëm dhe masa parandaluese ndaj klientëve që shfaqnin vështirësi për pagesë.

Sa i përket performancës së menaxhimit të KJP-ve, gjatë vitit 2020 BKT Kosova arriti ta ulë më tej proporcionin e KJP-ve në 1.99% krahasuar me dhjetorin 2019 që ishte 2.65%. Duhet theksuar trendin në rënie të KJP-ve si rezultat i arkëtimit dhe mbylljes së disa rasteve të vjetra dhe problematike.



Viti 2020 do të mbahet mend si vit shumë sfidues sa i përket arkëtimit dhe menaxhimit të kredive, i cili rezultoi me KJP më të ulët të Bankës në dy vitet e fundit. Për të përparuar më tutje me performancën e menaxhimit të KJP-ve, BKT Kosova është duke punuar në forcimin e strukturave, sistemeve dhe burimeve të saj duke zbatuar ide të reja dhe praktikat më të mira.

Gjatë vitit 2020, përkundër pandemisë Covid-19 dhe rrethanat e krijuara nga pandemia, çështjet ligjore u trajtuan në përputhje me kërkesat ligjore dhe biznesin dhe nevojat e klientëve, duke ofruar kështu zgjidhje ligjore të duhura - zgjidhje ligjore që kanë kontribuar në arritjen e objektivave dhe prioriteteve të përcaktuara nga banka. Megjithëse gjykatat dhe institucionet e tjera të zbatimit të ligjit gjatë periudhës së pandemisë kishin aktivitete kryesisht të kufizuara, Departamenti Ligjor përdori periudhat kur kishte aktivitet nga institucionet e zbatimit të ligjit për t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore duke siguruar mbrojtjen e nevojshme ligjore të interesave të bankës. Përveç aktiviteteve të përditshme, Departamenti Ligjor ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme, takime online, diskutime në institucione të ndryshme (qendrore dhe lokale), në mënyrë që të gjejë zgjidhje në lidhje me zbatimin e vendimeve të Qeverisë në interes të klientëve duke propozuar dhe ofruar zgjidhje konkrete ligjore gjithmonë në interesin më të mirë të klientëve dhe bankës.

Viti 2020 ishte një vit sfidues për shkak të pandemisë Covid-19. Sidoqoftë Departamenti i Vlerësimit të Kredive gjatë këtij viti i ka koordinuar aktivitetet në një mënyrë që të gjitha kërkesat për kredi të trajtohen në kohë duke përmbushur nevojën financiare të klientëve. Nga ana tjetër, përveç operacioneve ditore me burime të kufizuara të punonjësve, banka prapë ka arritur shumë qëllime tjera duke kontribuar në automatizimin e proceseve dhe përmirësimet e proceseve.

Me anë të kësaj, departamenti relevant me palët e lidhura janë përfshirë në projektet për digjitalizimin e kredive dhe projekte tjera të brendshme duke shqyrtuar dhe vlerësuar proceset ekzistuese dhe duke mirëpritur që të optimizohet puna në retail dhe operacionet e biznesit për një vendimmarrje më të shpejtë dhe më të saktë.







Si institucion financiar bankar me përqendrim në përkrahjen e nevojave financiare të klientëve në aspektin e investimeve të afatshkurtra ose të gjata dhe mirëmbajtjen e fondeve të tyre, Funksioni i Rrezikut i bankës është i angazhuar për të siguruar stabilitet financiar dhe siguri për të dyja palët, si për organizatën edhe për klientët e saj. Për një funksion efektiv dhe të shëndetshëm të menaxhimit të rrezikut, ndiqet qasja e vendosjes së pikave të kontrollit të brendshëm mbi secilin proces/aktivitet në vijën e parë/të dytë të mbrojtjes të ndjekur nga Grupi i pavarur i Menaxhimit të Rrezikut (përfshirë funksionin e rrezikut kreditor, rrezikut të tregut dhe të likuiditetit, rrezikut operacional) në kuadrin e organizimit të strukturës me raportim të drejtpërdrejtë te Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Bordi i Drejtorëve. Funksioni i menaxhimit të rrezikut është i angazhuar në zhvillimin e politikave të rrezikut kreditor, rrezikut të tregut, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut operacional në përputhje me strategjinë e bankës dhe oreksin e rrezikut të bankës dhe duke operuar në përputhje me legjislacionin dhe kërkesat e kornizës rregullative.

Detajet e funksionit të menaxhimit të rrezikut në lidhje me rrezikun kreditor, të tregut dhe rrezikun e likuiditetit janë prezantuar në raportin e audituar financiar.

Paraqitja e jashtëzakonshme e rrezikut nga COVID-19 gjatë vitit 2020, në veçanti ndikoi në sektorin bankar duke e bërë të luhatshme gjendjen e tregut, duke e përkeqësuar cilësinë e kredive dhe vazhdimësinë e biznesit ndër të tjera. Me përkeqësimin e sektorit ekonomik që ndikoi drejtpërdrejt në aftësinë kreditore të bizneseve dhe klientëve individualë, funksioni i rrezikut duhej të reagonte shpejt për të miratuar procese/praktika të reja në përputhje me matjen e masave të reja kufizuese të qeverisë dhe kërkesën e re rregullative për të siguruar vazhdimësi të biznesit dhe stabilitet financiar duke e menaxhuar në veçanti rrezikun kreditor, të tregut dhe të likuiditetit. Politikat dhe procedurat janë rishikuar duke i rishpërndarë limitet e bazuara në rrezik, duke pasqyruar kërkesën e re rregullative, duke ndjekur praktikat më të mira të rrezikut dhe udhëzimet përkatëse të COVID-19 mbi provizionet e kredive, modelimin e stres testeve, analizën e shpejtë të rrezikut kreditor, rivlerësimin e kolateralit, por jo të kufizuara.

Me pezullimin e Rregullores së veçantë ekzistuese të Bankës Qendrore dhe udhëzimet e reja në fuqi, BQK synoi lehtësimin e masave për sektorin bankar dhe lehtësimin e klientëve nga përmbushja e detyrimeve financiare ndaj bankave brenda një periudhe të caktuar përmes moratoriumit dhe ristrukturimit të borxhit të tyre në mënyrë që të ruajë një stabilitet financiar për sektorin bankar si dhe për klientët. Në përgjigje të kësaj, banka reagoi duke i modifikuar politikat e saj të rrezikut për t'iu mundësuar klientëve një shtyrje të borxheve të tyre përmes të cilës në mënyrë indirekte përkrah edhe sektorë të caktuar të ekonomisë së vendit. Me rritjen e rrezikut kreditor për shkak të pasigurisë së ndikimit të COVID-19 mbi sektorët ekonomikë, përmes një funksioni të veçantë të menaxhimit të rrezikut të mospagesës, janë forcuar praktikat mbi monitorimin e portfolios dhe qasjet e rikuperimit. Si rezultat, përmes një funksioni të duhur të menaxhimit të rrezikut dhe koordinimit brenda proceseve të bankës dhe bashkëpunimit me klientët dhe BQK-në, banka ka arritur ta menaxhojë me sukses rrezikun e saj kreditor gjatë periudhës së krizës brenda vitit 2020.
Për shkak të luhatshmërisë së lartë të tregut dhe sjelljeve të klientëve, banka ka përfshirë skenarët e COVID-19 në stres teste dhe ka rregulluar modelet ekzistuese në mënyrë që të vlerësohen ndikimet e mundshme dhe të sigurohet veprimi i duhur në krizë dhe të sigurojë përdorim efikas të kapitalit dhe mbajtjen e një niveli stabil të likuiditetit.

Digjitalizimi i produkteve dhe shërbimeve ishte ngjitur më lart sesa planet strategjike të bankës gjatë kohës së pandemisë si formë e përgjigjeve më të shpejta dhe ofertave të zgjidhjeve për klientët të cilët për shkak të bllokimit kishin qasje të kufizuar fizike në shërbimet bankare. Kështu, me ndryshimin dhe thjeshtësimin e proceseve operacionale funksioni i rrezikut ishte i vendosur për të siguruar kontrollet e duhura për ta ulur rrezikun që vjen nga proceset e reja të shkaktuara nga klientët dhe punonjësit e bankës.

15 Burimet Njerëzore dhe Trajnimet





Që nga fundi i vitit 2019 Departamenti i Burimeve Njerëzore është angazhuar në maksimizimin e performancës së fuqisë punëtore me eksperiencë për të mbështetur Linjat e Biznesit në arritjen e objektivave vjetore të përcaktuara për vitin 2020.

Viti 2020 ishte vit shumë sfidues, por banka operoi me qëllime të mëdha e te qarta për të arritur majat e suksesit si bankë në tregun e Kosovës. Vetëm në muajt janar dhe shkurt të vitit 2020 janë punësuar 33 punonjës të rinj, por përgatitja për arritje të objektivave u sfidua dhe u ngadalësua me ardhjen e muajit mars, kur edhe ka filluar mbyllja si masë mbrojtëse nga pandemia.

Kështu, edhe puna me burimet njerëzore në një mënyrë ose tjetër është orientuar në një drejtim tjetër, në aspektin që më tepër është fokusuar në shëndetin dhe sigurinë e punonjësve në vendin e punës, duke e ndryshuar edhe rutinën e përditshme të punës. Përveç kësaj ndikimi ka qenë edhe në planifikimet e trajnimeve si dhe rekrutimeve, ku çdo gjë u orientua në punë nga distanca dhe BKT iu përshtat kohës në përdorimin e teknologjisë.

Puna në distancë edhe pse e menduar më herët për disa pozita në BKT, gjatë kësaj periudhe u bë e domosdoshme. BKT u mobilizua duke krijuar qasje nga distanca për departamentet specifike për të siguruar vazhdimësinë e punës.

Përparësitë e të punuarit nga shtëpia patën ndikim pozitiv tek punonjësit në mënyrë që shëndeti publik të ruhej, e efekti pozitiv ishte evident sidomos tek prindërit të cilët duhej të kujdeseshin për fëmijët e tyre si pasojë e mbylljes së kopshteve dhe shkollave.

Në të njëjtën kohë, Departamenti i Burimeve Njerëzore shfrytëzoi këtë mundësi që për të ardhmen të përdorë të dhënat e të punuarit nga shtëpia gjatë kësaj kohe, për të krijuar një rutinë të tillë edhe në të ardhmen.

Në shumicën e rasteve puna nga shtëpia ka funksionuar shumë mirë dhe pa probleme dhe me kohë u bë shumë e mirëseardhur për punonjësit, të cilët kohë pas kohe duhet të përshtatnin orarin e punës dhe kujdesjen ndaj anëtarëve të familjes në nevojë.

Një ambient pune nga shtëpia për shumë punonjës e zgjati orarin e punës, të cilët u munduan që çdo detyrë ta përfundojnë pavarësisht orarit zyrtar të punës, ku për këtë arsye BNj ka krijuar dhe identifikuar mënyrat e vlerësimit të punonjësve që kanë punuar nga shtëpia në mënyrë që mos të ketë dallime nga të gjithë punonjësit e tjerë.

Puna në distancë do të jetë tanimë pjesë e punës dhe mundësi e zgjedhjes për punonjësit në të ardhmen në përshtatjen e stilit të jetesës dhe ofrimit të shërbimeve për punëdhënësin. Një kombinim i punës nga shtëpia dhe nga ambienti i punës do të jetë mundësi e mirë që në të ardhmen të përdoret si stimulim dhe fleksibilitet që BKT mund ta ketë si punëdhënës.

“Puno fort në heshtje.
Lëre suksesin të bëjë zhurmë.”

- Frank Ocean -

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.

Pasqyrat financiare të përgatitura më dhe për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2020 me Raportin e Auditorit të Pavarur

PËRMBAJTJA

1
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

4
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET

6
PASQYRA E RRJEDHAVE TË PARASË

7–81
SHËNIMET MBI PASQYRAT FINANCIARE

Raporti i Auditorit të Pavarur

Grant Thornton LLC
Rexhep Mala 18
10000 Pristina
Kosovo

T +383 (0)38 247 801
F +383 (0)38 247 802
E Contact@ks.gt.com
VAT No. 330086000

Për Aksionarët e

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020, pasqyrën e ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Nderkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona nën këto standarde janë të sqaruara më tutje në seksionin e raportit tonë Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me kërkesat etike të cilat janë relevante në Kosovë për auditimin tonë të pasqyrave financiare dhe ne kemi përmbushur edhe përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit BSNEK-së. Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Bankës Kombëtare Tregtare Kosova Sh.a. më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë audituar nga një auditor tjetër i cili shprehu një opinion të pa modifikuar në raportin e tyre më 25 mars 2020.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrolle të brendshme, që konsiderohen të nevojshme nga menaxhmenti për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar se përmbushuri parimin e vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet që kanë të bëjnë më vijimësinë e biznesit dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë, përveç kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nuk ka ndonjë mundësi tjetër përveç se të veprojë në këtë menyrë.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Qëllimet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin që pasqyrat financiare në terësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve ashtu edhe e gabimeve, dhe lëshimin e një raporti auditimi i cili përmban opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion i asaj që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të, do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin si rezultat i mashtrimeve ose gabimeve dhe konsiderohen materiale nëse individualisht, ose të bashkuara, mund të pritet në mënyrë të arsyeshme që të ndikojnë në vendimet ekonomike të shfrytëzuesve të pasqyrave financiare, të marra bazuar në këto pasqyrave financiare.

Grant Thornton LLC is a member firm of Grant Thornton International Ltd (GTIL). GTIL and the member firms are not a worldwide partnership. GTIL and each member is a separate legal entity. Services are delivered by the member firms. GTIL does not provide services to clients. GTIL and its member firms are not agents of, and do not obligate, one another and are not liable for one another's acts or omissions.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, si pasojë nga mashtrimet apo edhe si pasojë e gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedura të auditimit të cilat i përgjigjen këtyre risqeve dhe marrim evidenca të auditimit të cilat janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Risku i mos-zbulimit të një anomalie materiale e cila rrjedhë nga mashtrimi është më i madh sesa i atij që rrjedhë nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që është relevante me auditimin në mënyrë që të dizajnojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme me rrethanat, mirëpo jo me qëllim për dhënien e një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e kontabilitetit si dhe shpalosjet e bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim përfundime në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së hipotezës së vijimësisë së kontabilitetit, duke u bazuar në evidencat e auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të shkaktojnë dyshim të lartë që Banka mund të vazhdojë operimin. Nëse ne vijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të terheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit në shpalosjet e pasqyrave financiare ose nëse shpalosjet e tilla janë jo të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat tona të auditimit të siguruara deri në datën e raportit tonë. Sidoqoftë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që Banka të ndërpresë së përmbushuri parimin e vijimësisë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajten e pasqyrave financiare duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare prezentojnë transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a., përpos të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Grant Thornton LLC
Prishtinë,
30 prill 2021

Suzana Stavrik
Auditor ligjor

GRANT THORNTON L.L.C. KOSOVO

Grant Thornton LLC is a member firm of Grant Thornton International Ltd (GTIL). GTIL and the member firms are not a worldwide partnership. GTIL and each member is a separate legal entity. Services are delivered by the member firms. GTIL does not provide services to clients. GTIL and its member firms are not agents of, and do not obligate, one another and are not liable for one another's acts or omissions.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.
Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat në EURO, përveçse kur deklarohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pasuritë			
Paraja dhe balancat në Bankën Qendrore	6	102,398,903	68,789,883
Plasmanet dhe balancat në banka	7	30,402,526	37,244,984
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	8	101,259,272	105,911,832
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	8	28,230,433	7,697,413
Të arkëtueshme nga BKT Shqipëria	25	38,658	25,139
Kreditë dhe paradhëniet te Bankat	9.1	32,008,794	-
Kreditë për klientët, neto	9.2	351,964,719	305,985,957
Prona dhe paisjet	10	15,957,343	2,343,011
Pasuri me të drejtë përdorimi	10.1	2,053,083	2,799,428
Pasuritë e paprekshme	11	43,633	12,052
Të arkëtueshmet nga tatimi	27	95,494	-
Pasuri tatimore e shtyrë	27	300,337	277,547
Pasuri të tjera	12	6,981,921	5,647,780
Gjithsej pasuritë		**671,735,116**	**536,735,026**
Detyrimet			
Depozitat e klientëve	13	539,308,400	449,152,204
Detyrimet ndaj bankave	14	12,509,157	4,661,073
Detyrimet e bazuara në Transaksionet Repo	14	22,066,897	-
Detyrimet ndaj BKT Shqipëria	14	1,320,571	774,405
Detyrimi i tatimit të shtyrë	27	-	196,960
Provizionet	24	654,968	536,621
Akrualet dhe detyrime të tjera	15	1,978,468	2,299,295
Detyrimet e qirasë	10.1	2,116,340	2,841,154
Huamarrjet	16	18,247,148	22,283,169
Gjithsej detyrimet		**598,201,949**	**482,744,881**
Kapitali			
Kapitali aksionar	17	31,000,000	22,000,000
Fitimi i akumuluar nga vitet paraprake		29,018,336	22,612,980
Fitimi për vitin		11,053,285	6,113,354
Rezerva e vlerës së drejtë		2,753,548	3,263,811
Rezerva të tjera		(292,002)	-
Gjithsej kapitali aksionar		**73,533,167**	**53,990,145**
Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar		**671,735,116**	**536,735,026**

Pasqyra e audituar e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 81 që janë pjesë e informacionit financiar të audituar.
Pasqyrat financiare janë autorizuar për lëshim nga Bordi i Drejtorëve më 21 prill 2021 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Suat Bakkal
Kryeshef Ekzekutiv dhe Anëtar i Bordit

Agon Skeja
Drejtues i Grupit të Financave dhe Administratës

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.
Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat në EURO, përveçse kur deklarohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Pasuritë			
Paraja dhe balancat në Bankën Qendrore	6	102,398,903	68,789,883
Plasmanet dhe balancat në banka	7	30,402,526	37,244,984
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	8	101,259,272	105,911,832
Pasuritë financiare me kosto të amortizuar	8	28,230,433	7,697,413
Të arkëtueshme nga BKT Shqipëria	25	38,658	25,139
Kreditë dhe paradhëniet te Bankat	9.1	32,008,794	-
Kreditë për klientët, neto	9.2	351,964,719	305,985,957
Prona dhe paisjet	10	15,957,343	2,343,011
Pasuri me të drejtë përdorimi	10.1	2,053,083	2,799,428
Pasuritë e paprekshme	11	43,633	12,052
Të arkëtueshmet nga tatimi	27	95,494	-
Pasuri tatimore e shtyrë	27	300,337	277,547
Pasuri të tjera	12	6,981,921	5,647,780
Gjithsej pasuritë		**671,735,116**	**536,735,026**
Detyrimet			
Depozitat e klientëve	13	539,308,400	449,152,204
Detyrimet ndaj bankave	14	12,509,157	4,661,073
Detyrimet e bazuara në Transaksionet Repo	14	22,066,897	-
Detyrimet ndaj BKT Shqipëria	14	1,320,571	774,405
Detyrimi i tatimit të shtyrë	27	-	196,960
Provizionet	24	654,968	536,621
Akrualet dhe detyrime të tjera	15	1,978,468	2,299,295
Detyrimet e qirasë	10.1	2,116,340	2,841,154
Huamarrjet	16	18,247,148	22,283,169
Gjithsej detyrimet		**598,201,949**	**482,744,881**
Kapitali			
Kapitali aksionar	17	31,000,000	22,000,000
Fitimi i akumuluar nga vitet paraprake		29,018,336	22,612,980
Fitimi për vitin		11,053,285	6,113,354
Rezerva e vlerës së drejtë		2,753,548	3,263,811
Rezerva të tjera		(292,002)	-
Gjithsej kapitali aksionar		**73,533,167**	**53,990,145**
Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar		**671,735,116**	**536,735,026**

Pasqyra e audituar e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 81 që janë pjesë e informacionit financiar të audituar.
Pasqyrat financiare janë autorizuar për lëshim nga Bordi i Drejtorëve më 21 prill 2021 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Suat Bakkal
Drejtor dhe Anëtar i Bordit

Agon Skeja
Dretues i Grupit të Financave dhe Administratës

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat në EURO, përveçse kur deklarohet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	18	25,699,458	21,243,614
Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	19	(5,495,560)	(4,220,136)
Të ardhurat neto nga interesi		**20,203,898**	**17,023,478**
Tarifat dhe komisionet, neto	20	4,357,849	3,637,206
Fitimi nga rivlerësimi i kursit të këmbimit, neto		79,388	(96,778)
Fitimi/(Humbja) nga shitja e letrave me vlerë të investimeve të matura në VDNATGJ	8	2,313,753	974,325
Fitimi / (Humbja) nga aktivitetet tregtare me valuta te huaja, neto		33,688	262,033
Të tjera (shpenzime) / të ardhura, neto	21	243,078	(1,776,426)
Të ardhura/Shpenzime të tjera, neto		**7,027,756**	**3,000,360**
Shpenzimet operative			
Shpenzimet e personelit	22	(4,994,245)	(4,315,654)
Shpenzimet administrative	23	(4,991,964)	(4,762,223)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 10.1, 11	(1,532,998)	(1,726,638)
Gjithsej shpenzimet operative		**(11,519,207)**	**(10,804,515)**
Shpenzimet e provizioneve për kreditë e klientëve	9	(3,341,681)	(2,531,376)
Shpenzimet e provizioneve të pasurive financiare, përveç kredive për klientët, dhe provizioneve për zërat jashtë-bilancor	24	(253,116)	(4,015)
Fitimi para tatimit në fitim		**12,217,842**	**6,683,932**
Shpenzimet e tatimi në fitim	**27**	**(1,164,557)**	**(570,578)**
Shpenzimi vjetor i tatimit mbi fitimin		(1,187,347)	(1,061,431)
Shpenzimi i shtyrë i tatimit mbi fitimin		22,790	490,853
Fitimi (Humbja) për vitin		**11,053,285**	**6,113,354**
Rivlerësimi i investimeve ne letra me vlerë		(510,263)	3,573,173
Të ardhura/shpenzime të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		**(510,263)**	**3,573,173**
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		**10,543,022**	**9,686,527**

Pasqyra e audituar e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 81 që janë pjesë e informacionit financiar të audituar.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a.
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat në EURO, përveçse kur deklarohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezervat e vlerës së drejtë	Rezervat e tjera	Fitimet e mbartura	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2019	**17,000,000**	**(309,362)**	**-**	**22,612,980**	**39,303,618**
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në kapital					
Kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët	-	-	-	-	-
Rritja në kapitalin aksionar	5,000,000	-	-	-	**5,000,000**
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në kapital	**5,000,000**	**-**	**-**	**-**	**5,000,000**
					-
Gjithësej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin					-
Fitimi për vitin	-	-	-	6,113,354	**6,113,354**
Rivlerësimi i letrave me vlerë të disponueshme për shitje, pa tatim mbi të ardhurat	-	3,573,173	-	-	**3,573,173**
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	**3,573,173**	**-**	**6,113,354**	**9,686,527**
Gjendja më 31 dhjetor 2019/1 janar 2020-siç thuhet	**22,000,000**	**3,263,811**	**-**	**28,726,334**	**53,990,145**
Efekti nga kalimi nga raportimi i BQK-së në raportimin e SNRF-ve sipas kërkesave të BQK-së	-	-	(292,002)	292,002	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019/1 janar 2020-*Riparaqitur*	**22,000,000**	**3,263,811**	**(292,002)**	**29,018,336**	**53,990,145**
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në kapital					
Kontributet nga dhe shpërndarjet për pronarët	-	-	-	-	-
Rritja në kapitalin aksionar	9,000,000	-	-	-	9,000,000
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në kapital	**9,000,000**	**-**	**-**	**-**	**9,000,000**
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin					
Fitmi për vitin	-	-	-	11,053,285	11,053,285
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 8)	-	(510,263)	-	-	(510,263)
Gjithsej fitimi gjithëpërfshirës për vitin	**-**	**(510,263)**	**-**	**11,053,285**	**10,543,022**
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**31,000,000**	**2,753,548**	**(292,002)**	**40,071,621**	**73,533,167**

Pasqyra e audituar e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 81 që janë pjesë e informacionit financiar të audituar.

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet operative:			
Fitimi para tatimit për vitin		12,217,842	6,683,932
Rregullimet për të barazuar ndryshimet në pasuritë neto me paratë e gatshme neto nga aktivitetet operative:			
Shpenzimet e interesit	19	5,495,560	4,220,136
Të ardhura nga interesi	18	(25,699,458)	(21,243,614)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10, 10.1, 11	1,532,998	1,726,638
Humbja nga heqja nga përdorimi i pasurive fikse		-	(50,887)
Fitimi / humbja nga shitja e letrave me vlerë të investimeve		(2,313,753)	(974,325)
Fitimi për rikuperimin e kredive të shlyera për klientët		(261,782)	(201,765)
Shlyerja e kredive për klientët		622,978	3,233,656
Të ardhura të tjera jo-monetare		-	(1,900,666)
Zhvlerësimi i kredisë për klientët		3,241,487	1,198,386
Zhvlerësimi i pasurive të tjera financiare		253,116	4,015
Zhvlerësimi i pasurive të tjera		-	225,002
Rrjedhat e parasë nga fitimi operativ para ndryshimeve në pasuritë dhe detyrimet operative		**(4,911,012)**	**(7,079,492)**
(Rritja)/Zvogëlimi në pasuritë operative:			
Balancat e kufizuara me Bankën Qendrore		(4,165,605)	(5,765,776)
Plasmanet dhe balancat me banka		(3,043,411)	(3,044,223)
Kreditë për bankat	9.1	(32,000,000)	-
Kreditë për klientët	9.2	(49,405,274)	(60,208,934)
Të arkëtueshmet nga BKT Shqipëria		(13,519)	12,776,497
Pasuri të tjera		(1,429,937)	(921,209)
		(90,057,746)	**(57,163,645)**
Rritja/(Zvogëlimi) në detyrimet operative:			
Detyrimet ndaj klientëve		89,997,119	97,361,361
Detyrimet ndaj bankave		7,873,869	(13,177,663)
Detyrimet ndaj BKT Shqipërisë		22,613,063	774,405
Akrualet dhe detyrime të tjera		(679,846)	78,178
Detyrimet e qirasë		78,350	-
Humbjet nga zhvlerësimi i pasurive financiare, përveç kredive për klientët, dhe provizionet për zërat jashtë-bilancor (për t'u bërë zero)		(33,072)	-
		119,849,483	**85,036,281**
Interesi i paguar		(5,282,727)	(3,686,157)
Interesi i paguar SNRF 16		(78,340)	(99,994)
Interesi i pranuar		24,770,121	19,391,991
Tatimet në të ardhura të paguara		(1,024,997)	(508,768)
Rrjedhat neto e parasë nga / (përdorur në) aktivitetet operative		**43,264,782**	**35,890,216**
Rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet investuese		-	-
Të ardhurat nga shitja e letrave me vlerë të investimeve		(13,366,534)	(31,378,004)
Blerjet e pasurive dhe pajisjeve		(14,432,566)	(1,447,055)
Të ardhurat nga shitja e pronave, impianteve dhe pajisjeve		-	50,887
Rrjedhat e parasë nga/ (përdorur në) aktivitetet investuese		**(27,799,100)**	**(32,774,172)**
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese			
(Pagesat e)/ Të ardhurat nga detyrimet ndaj bankave		(4,037,222)	18,179,999
Shtimi i kapitalit		9,000,000	5,000,000
Ndryshimi në principalin e qirasë		(803,153)	(801,412)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitet financuese		**4,159,625**	**22,378,587**
Rrjedha neto në paratë dhe ekuivalentët e saj		**19,625,307**	**25,494,631**
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës		71,510,222	46,015,591
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të periudhës		**91,135,529**	**71,510,222**

Pasqyra e audituar e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet e paraqitura në faqet 7 deri 81 që janë pjesë e informacionit financiar të audituar.

1. Të përgjithshme

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë sh.a ("Banka") është një bankë tregtare e cila ofron një gamë të gjerë të shërbimeve. Banka ofron shërbime bankare për kompanitë publike dhe private, si dhe individëve në Kosovë.

Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a. ("Banka") është në pronësi të plotë të bankës shqiptare Banka Kombëtare Tregtare sh.a. ("BKT"). BKT- Kosova është regjistruar më 30 gusht 2007 në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK"), për të vepruar si bankë në Republikën e Kosovës dhe është subjekt i rregulloreve të BQK-së. Më 30 prill, 2018, Banka Kombëtare Tregtare Dega në Kosovë ndryshoi statusin e saj nga degë e huaj në Shoqëri Aksionare. Licensa e saj bankare ndryshoi nga Banka Kombëtare Tregare - Dega në Kosovë në Banka Kombëtare Tregtare Kosovë Sh.a. Banka ofron një gamë të gjerë të shërbimeve universale për ndërmarrjet private dhe shtetërore, dhe individët në Republikën e Kosovës. Burimi kryesor i financimit të Bankës janë depozitat, të cilat janë pranuar në forma të ndryshme duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat dhe pa afat, si në Euro ashtu edhe në valutë të huaj. BKT ofron një shumëllojshmëri të kredive të korporatave dhe të konsumit, karta debiti dhe krediti, shërbime përmes bankomatit, kanale alternative të sofistikuara, shërbime të kualifikuara ndërkombëtare bankare dhe produkte të ndryshme të thesarit. Rrjeti i BKT Kosova përfshin 26 njësi. Shtatë njësi janë të vendosura në Prishtinë, dhe njësitë e tjera janë të vendosura në Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Vushtrri, Fushë Kosovë, Podujevë, Drenas, Rahovec, Viti dhe Lipjan, Aeroporti i Prishtinës dhe Skenderaj. Numri i të punësuarve në fund të vitit 2020 ka qenë 389 (2019: 358).

Share capital
Me 31 dhjetor 2020 kapitali aksionar i autorizuar është 31,000,000 euro (2019: 22,000,000 euro). Banka është një shoqëri aksionare 100% në pronësi të Banka Kombëtare Tregtare Sh.a. në Shqipëri. Të gjitha aksionet e emetuara janë të paguara plotësisht. Bartësi i aksioneve ka të drejtë të marrë dividendë, nëse ato deklarohen. Të gjitha asetet janë të rankuara njësoj marrë paraqysh asetet reziduale të Bankës.
Mbi vendimin e aksionarëve të datës 25 qershor 2020, kapitali i bankës ishte rritur nga 22,000,000 euro në 31,000,000 euro përmes injektimit të kapitalit të performuar më 29 qershor 2020.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-të). Ato janë përgatitur nën supozimin se Banka operon mbi bazën e parimit të vijimësisë.

Banka ka marrë në konsideratë ndikimin e Covid-19 në përgatitjen e pasqyrave financiare. Ndërsa fushat specifike të gjykimit mund të mos ndryshojnë, ndikimi i Covid-19 rezultoi në aplikimin e gjykimit të mëtejshëm brenda atyre zonave, për shkak të natyrës evolucionare të pandemisë dhe përvojës së kufizuar të ndikimeve ekonomike dhe financiare të një ngjarjeje të tillë.

Më shumë informacion në lidhje me rrethanat e shkaktuara nga pandemia globale e COVID-19 që ndikuan në operacionet dhe aktivitetet e Bankës në vitin 2020 shpalosen në Shënimin nr. 4. Këto rrethana nuk ndikuan në përshtatshmërinë e supozimit të parimit të vijimësisë së Bankës.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç pasurive financiare në dispozicion për shitje, të cilat janë të matura me vlerën e drejtë.

Për më tepër, për qëllime të raportimit financiar, matjet me vlerën e drejtë kategorizohen në Nivelin 1, 2 ose 3 në bazë të shkallës në të cilën të dhënat për matjen e vlerës së drejtë janë të vëzhgueshme dhe mund të kenë një efekt të rëndëshishëm në tërësinë e tij, të cilat janë përshkruar si më poshtë:

- Niveli 1 përfshin të dhënat me çmimet e kuotuara (të pakorrigjuara) në tregjet aktive për pasuritë e njëjta ose detyrimet që ndërmarrja mund t'iu qaset në datën e matjes;
- Niveli 2 përfshin të dhënat përveç të dhënave me çmimet e kuotuara të përfshira në Nivelin 1, që janë të vëzhgueshme për pasuritë dhe detyrimet, qoftë në mënyrë direkte apo indirekt; dhe
- Niveli 3 të dhënat që janë të pa vëzhgueshme për pasuritë ose detyrimet.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro, e cila është edhe monedha funksionale e Bankës.

